



Raporti vjetor 2014

Të jetojmë nga toka dhe puna jonë!

Shkojmë përpara

Viti 2014 ka qenë një vit jubilar për IADK sepse është 10 vjetori i themelimit të saj.

Për 10 vite IADK ka kaluar sfida por edhe ka treguar suksese në programin e saj. Ne arritëm që të stabilizohemi si dhe të krijojmë një organizatë model në Kosovë me parime të shëndosha të cilat me krenari i ruajmë dhe afirmojmë; profesionalizmi dhe puna ekipore, transparenca, jo-diskriminimi dhe bilanci gjinor si dhe përfshirja e grupeve minoritare dhe grupet e marginalizuara.

Gjatë këtyre 10 viteve IADK ka zbatuar 48 projekte me vlerë prej 5,575,827 Euro dhe ju ka shërbyer 19,950 fermerëve të cilët në forma të ndryshme kanë përfituar nga programi dhe projektet e IADK-së. Tani IADK ka një infrastrukturë në sipërfaqe prej 900 m² për zyra dhe salla trajnimesh, 1000 m² për parkim, ka kushtet ideale për punë në zyra si dhe hapësirë për mbajtjen e trajnimeve për fermerë.



Meritat kryesore të këtij suksesi të IADK-së i atribuohen; përkrahjes së Bordit të Drejtorëve, përkushtimit të stafit në punë, besimit të donatorëve si dhe punës dhe guximit të fermerëve për zbatimin e teknikave të reja dhe përcjelljen e këshillave të ekspertëve të IADK-së.

Ky vit për IADK-në do të mbahet mend edhe me zgjerimin e partnerëve që përkrahin projektet e IADK-së; Ambasada holandeze, Ambasada kanadeze, rritja e shërbimeve këshillimore me OJQ-ët, LAB-in, UNDP-in, Komuna e Vushtrisë etj. Përfundimi i tri projekteve të mëdha; dy me Zyrën e BE-së në Kosovë (ZBEK), si dhe projekti ECoFK me donatorët tradicional BfdW dhe CoS. Auditimi dhe evaluimi i jashtëm i projektit ECoFK kanë qenë shumë pozitive dhe motivuese për IADK-ën.

Mbulimi i tërë Kosovës me aktivitete të IADK-së, ka qenë sfidë e radhës të cilën me suksese e kemi tejkaluar, derisa IADK do të vazhdojë me përkushtim edhe më të madh për Akreditimin dhe Licencimin për shërbime nga Institucionet relevante, të Qendrës Edukuese Bujqësore në Vushtri (IADK).

Për me tepër informata ju lutem kontaktoni:

Zenel Bunjaku

Drejtor ekzekutiv

Sfarqak i Ulët p/n

42000 Vushtri

Kosovë

Tel/Fax +381 (0) 28 536 726

Përmbajtja

Partnerët që kanë mbështetur projektet e IADK-së gjatë vitit

2014.....**Error! Bookmark not defined.**

Departamenti i hortikulturës.....4

Departamenti i blegtorisë.....9

Organizimi i fermerëve.....11

Departamenti i përpunimit të ushqimit.....12

Ngritja e kapaciteteve dhe fuqizimi ekonomik i grave kryefamiljare.....14

Fuqizimi i grave në sektorin e bujqësisë dhe krijimi i lidhjeve me tregun.....15

Promovimi shërbimeve të turizmit rural dhe infrastrukturës në zonën e shalës.....16

Trajnimet dhe monitorimet.....19

Fuqizimi i kapacitetit të shoqërisë civile për politikëbërje dhe konsultim me qeverinë në sektorin e bujqësisë.....20

Shërbime tjera nga IADK.....25

Trajnimet promovuese.....25

Publikimet.....27

Aktivitete me partnerë profesional internacional.....28

Tregim suksesi - kuzhinieret që sfidojnë paragjykimet.....29

Partnerët që kanë mbështetur projektet e IADK-së gjatë vitit 2014

Viti 2014 për IADK-në ka qenë një vit i angazhimeve tejet të mëdha në zbatimin e projekteve të ndryshme në fushën e bujqësisë dhe në sfera tjera të zhvillimit rural. Mirëpo falë punës së palodhshme të gjithë stafit, përkushtimit dhe bashkëpunimit të singertë të partnerëve dhe sidomos kushteve të mira të punës që janë krijuar me ndërtimin e objektit përkatësisht Qendrës për Edukimin e Fermerëve, IADK me sukses ka arrit të fillojë dhe përmbyllë vitin 2014 me aktivitete të ndryshme në përkrahje të fermerëve në zhvillimin e bujqësisë.

Gjatë këtij viti IADK ka vazhduar të zbatojë projektin tre vjeçar ECoFK (2012-2014), të financuar nga një konzorcium donatorësh; **Brot für die Welt** (nga Gjermania) dhe **Church of Sweden CoS** (nga Suedia) lidhur me edukimin dhe organizimin e fermerëve, si dhe me prezantimin e aktiviteteve të reja bujqësore.

Partner tjerë të rëndësishëm janë; Bashkimi **Evropian** që ka financuar Dy projekte:

Projekt dyvjeçar 2013-2014 në Promovimin e turizmit rural dhe krijimin e infrastrukturës në zonën e Shalës.

Projekti dyvjeçar 2012-2014 në Fuqizimin e shoqërisë civile në politikë bërje në sektorin e bujqësisë.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural po ashtu ka financuar dy projekte:

Projektin dy vjeçar 2013-2014 në Rrjetin e të Dhënave për Kontabilitet të Fermave në Kosovë (RrDHKFK).

Projektin për shoqata “Promovimi i kultivimit të bimëve mjekësore, energjisë diellore dhe silazhimit në bujqësi”.

Ambasada e Mbretërisë Holandeze ka financuar projektin MATRA (Përkrahja e zhvillimit ekonomik dhe pajtimi në mes të fermerëve shqiptar, serb dhe të komuniteteve të ndryshme në veri të Kosovës”).

UNDP është një partner tjetër që ka financuar projektet si janë: “ Prodhimi i perimeve në ambiente të mbyllura në Mitrovicën Jugore”, pasta projektin “Ngritja e kapaciteteve lokale në gjenerimin e punësimit” në komunën e Shtërpçës dhe Dragashit, si dhe projektin “Ngritja e kapaciteteve të fermerëve në hortikulturë në komunat e rajonit veri dhe jug të Kosovës”.

Ambasada Kanadeze ka përkrah një projekt afatshkurtër “Fuqizimi i grave në sektorin e bujqësisë dhe krijimi i lidhjeve me tregun”.

Komuna e Vushtrrisë po ashtu ka vazhduar të jetë partner i rëndësishëm për IADK-në, ku gjatë vitit ka bashkë financuar disa projekte për përkrahje të fermerëve, pastaj ofrimin e shërbimeve këshillimore, si dhe një projekt për kultivimin e mjedrës.

Laboratori për Aktivitete të Biznesit (LAB) është një partner nga Hani i Elezit që ka angazhuar IADK-në në kryerjen e disa shërbime profesionale për fermerë në fushën e hortikulturës dhe shërbime administrative, financiare dhe menaxheriale për stafin e LAB-it.

Swiss kontakti po ashtu është një nga partnerët që IADK ka pas një bashkëpunim në vitin 2014.

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të stafit të IADK-së dhe promovimit të praktikave të reja në sektorin e bujqësisë, gjatë vitit 2014 ka vazhduar bashkëpunimi me organizatat me **Ekspertët Seniorë nga Holanda (PUM)** dhe me **Shoqatën e Fermerëve nga Normandia e Ulët të Francës (AFDI)** ku me këto dy organizata është bërë shkëmbimi i përvojave në sektorët e bujqësisë.

Shtirirja e aktiviteteve:

Komunat: Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj, Zveçan, Zubin Potok, Leposaviq, Drenas, Podujevë, Hani i Elezit, Dragash, Shtërpçë, Prizren, Mamushë, Rahovec, Suharekë dhe Malishevë ndërsa me projektet fuqizimin e shoqërisë civile në politik bërje në sektorin e bujqësisë dhe në rrjetin e kontabilitetit të fermave në tërë Kosovën.

Përfituesit e programit për vitin 2014

175 Familje kanë përfituar mbështetje direkte nga programet e IADK-së, dhe atë:

- Pajisje për Bletari
- Boksa për viça
- Makine për silazhimin e barit
- Makinë mjelëse për Lopë
- Implementimi i praktikave të mira sipas standardeve GMP
- Fidanë dhe inpute për kultivimin e sherbelës, mjedrës dhe korishtonit
- Fara dhe inpute për prodhimtarin organike të perimeve
- Serra tunel për kultivim të perimeve me sipërfaqe 100 dhe 200m²
- Serra tunel 50m² për tharjen e bimëve mjekësore;
- Inkubatorë për mbirjen e farave të perimeve,
- Paketime (arka) për dredhëza, domate IP & organike dhe molla IP
- Pikë Përpunuese e pemëve dhe perimeve,
- Pajisje të kuzhinës për gatim të ushqimit shkolla,
- Pajisje të ndryshme për përpunim të qumështit, pemëve dhe perimeve
- Instalimi i turbinës për prodhimin e energjisë me anë të ujit,
- Rregullimi i shtegut për ecje dhe rregullimi i kroit,
- Furnizimi i dy restoranteve me biçikleta malore dhe pajisje për kuzhina,
- Furnizimi i mullirit me thasë për paketim të miellit dhe makinë për qepjen e thasëve
- Rregullimi i odave (Bujtinave)

2602 Fermerë (pjesëmarrës), kanë marrë pjesë në **194** sesione të trajnimeve:

47 Sesione të trajnimeve në sektorin e Blegtorisë, me gjithsejt **508** pjesëmarrës,

78 Sesione të trajnimeve në sektorin e Hortikulturës, me gjithsejt **1003** pjesëmarrës,

21 Sesione të trajnimeve në sektorin e Përpunimit Shtëpiak, me **299** pjesëmarrës

48 Sesione të trajnimeve janë mbajtur në sektorin e Menaxhimit të Bizneseve, **792** pjesm.

10 Workshope, me gjithsejt **264** pjesëmarrës nga sektorë të ndryshme të bujqësisë

8 Çertifikimi i **178** fermereve

1 Tryezë e rrumbullakët, ku kanë marrë pjesë **21** persona

4 Pjesëmarrje në Panair Regjionale të Bujqësisë, **50** fermerë kanë ekspozuar produktet

14 Ngjarje të IADK-së janë mbajtur ku kanë marrë pjesë **750** pjesëmarrës

Stafi i IADK-së ka kontribuar nëpërmjet grupeve të ndryshme punuese në përgatitjen e strategjive, ligjeve, kritereve etj., të cilat janë organizuar nga institucionet dhe organizatat lokale, regjionale dhe kombëtare.

DEPARTAMENTI I HORTIKULTURËS

Inkubatorët për mbirje të farave

Përfituesit e inkubatorëve për mbirje të farërave të perimeve kanë vazhduar të përdorin inkubatorët edhe gjatë vitit 2014, ku shfrytëzimi i tyre ka lehtësuar prodhimin fidanëve me cilësi më të mirë dhe kosto më të ulët.

Në fazën e prodhimit të fidanëve është bërë monitorimi i përfituesve, të cilët kanë prodhuar afër gjysmë milioni fidanë të perimeve dhe luleve, që do të thotë se mesatarisht secili përfitues ka prodhuar nga 100 mijë fidanë.



Prodhimtaria e integruar e pemëve dhe perimeve

Dy grupet e fermerëve të përfshirë në prodhimin e integruar të pemëve dhe perimeve kanë vazhduar edhe gjatë vitit 2014 të aplikojnë menaxhimin e integruar të dëmtuesve dhe janë monitoruar gjatë vegjetacionit. Për përcaktimin e momentit më të përshtatshëm për trajtimin e pemëve për mbrojtje nga sëmundjet janë shfrytëzuar të dhënat nga stacionet meteorologjike të cilat IADK i ka të vendosura në teren, dhe në momentet më kritike të përhapjes së infeksioneve janë dhënë rekomandimet përmes Ueb faqes dhe kontakteve përmes telefonave që fermerët të bëjnë trajtimin e pemëve. Të gjithë fermerët e përfshirë në këtë prodhimtari kanë marrë nga 300 arka për vendosjen frutave, në të cilat kanë qenë logot përkatëse që informojnë konsumatorët për mënyrën e prodhimit, si dhe fletushka në të cilat janë cekur disa nga përparësitë që ka prodhimtaria e integruar bujqësore në krahasim me atë konvencionale.



Asistimi i fermerëve në kalim në prodhimtarinë organike

Në kuadër të prodhimtarisë organike të perimeve në serra përveç përfituesit të serrës organike janë përkrahur edhe 5 fermerë tjerë me farëra të domates, rrjeta antiinsekt, plehra organike industriale, bletë polenizuese dhe predator për mbrojtje biologjike të perimeve. Edhe pse viti 2014 ka qenë një vit me të reshura të shpeshta gjatë vegjetacionit të perimeve, të cilat kanë favorizuar shumë përhapjen e sëmundjeve dhe dëmtuesve, fermerët të cilët janë asistuar në prodhimin organik të perimeve në serra kanë evituar me sukses pasojat nga infeksionet e kërpudhave dhe dëmtuesit tjerë. Janë organizuar edhe ditë fushore të fermerët që janë asistuar të prodhojnë perime në mënyrë organike në Pejë, Podujevë, Shtime dhe Vushtrri, me grupe të fermerëve dhe zyrtarë komunal për bujqësi, me qëllim të promovimit të praktikave të rritjes organike të perimeve në serra. Me dy grupe të fermerëve janë realizuar vizita studimore dy ditore në Maqedoni me qëllim të shkëmbimit të përvojave të fermerëve në prodhimin dhe marketingun e perimeve organike.



Serra për prodhimtari organike të perimeve

Edhe gjatë vitit 2014 ka vazhduar prodhimtaria e perimeve në mënyrë organike në serrën demonstruese, e cila është shfrytëzuar për prodhim të perimeve si dhe për demonstrim të praktikave të rritjes së perimeve në mënyrë organike. Serra që ka 500m² është mbjell në dhjetëditëshin e tretë të muajit prill fidanë të domates menjëherë pas dëmtimit prej 2.2 bimë/m², dhe në sajë të përgatitjes cilësore të tokës, përdorimit të plehrave organike, për kujdesit të drejtë dhe mbrojtjes biologjike ndaj sëmundjeve dhe

dëmtuesve është arrit një prodhim prej 10 ton me domate tejet cilësore dhe plasimin e tyre fermeri e ka bërë kryesisht në tregun e Prishtinës dhe Vushtrrisë me një çmim mesatar prej 0.50 €/kg. Fermeri është përkrahur edhe me 1000 arka për vendosjen e domateve, 500 fletëpalosje me të dhëna për prodhimin e domateve në serrën demonstruese, si dhe një standë druri për vendosjen e arkave gjatë plasimit të domateve në tregjet lokale apo markete të ndryshme. Në sezonën vjeshtore serra është mbjellë me spinaq.



Serra për prodhimin organik të perimeve



Plasimi i domateve organike në treg

Për të bërë inspektimin dhe certifikimin e prodhimeve organike IADK ka angazhuar një trupën inspektuese “Albinspekt” nga Shqipëria, pasi që në Kosovë ende nuk janë krijuar organe inspektuese për kontroll të prodhimeve organike. Trupa inspektuese ka bërë një inspektim në fillim të vegjetacionit të domateve dhe fermeri në mbështetje të stafit përgjegjës të IADK-së ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe i janë përmbajtur sugjerimeve që ka dhënë trupa inspektuese, mirëpo certifikimi organik është një proces që nuk mundë të ndodhë brenda viti, por kërkon të paktën dy vite si fazë kalimtare nga prodhimtaria konvencionale në atë organike. Megjithatë puna që është bërë në këtë aktivitet ka ofruar njohuri për fermerin dhe IADK-në për procedurat e inspektimit dhe certifikimit të prodhimtarisë bujqësore, dhe se fermeri është në rrugë të mbarë për të vazhduar prodhimin organik të perimeve dhe për të certifikuar perimet e prodhuara në serrën demonstruese.

Kultivimi i dredhëzës, mjedrës dhe manaferrës në veri

Në vitin e kaluar IADK ka përkrahur fermerët nga komuniteti serb në veri në ngritjen e plantacioneve të frutave të imëta, e këtë vit është bërë monitorimi i tyre. Kultivimi i dredhëzave ka pas shtrirje në komunën e Zveçanit dhe të Leposaviqit, dhe se në secilin prej 8 plantacioneve me sipërfaqe nga 1000 m², janë prodhuar mesatarisht nga 3500 kg fruta të dredhëzave të kualitetit shumë të lartë dhe janë plasuar me një çmim mesatar nga 1.3-1.5 €/kg. Ndërsa kultivimi i mjedrës dhe manaferrës ka pas shtrirje kryesisht në komunën Zubin Potok –ut, ku vitin e kaluar janë mbjellë 5 ngastra me nga 1000 m² me mjedër apo kombinim edhe me manaferrë ku bimët kanë pas një rritje dhe zhvillim shumë të mirë gjatë vegjetacionit dhe premtojnë një prodhimtari të lartë të frutave nga viti i ardhshëm. Po ashtu në këtë komunë gjatë vitit 2014 janë përkrahur edhe 5 fermerë tjerë me fidanë dhe inpute tjera përcjellëse për kultivimin e mjedrës përkatësisht kultivarit Polka, e që është një kultivarë në perspektiv ngase hynë në prodhimtari që nga viti i parë dhe viteve të fundit ka një treg të sigurt të plasim it të frutave. Fermerët kanë përgatitur me kohë



ngastrat për mbjellje dhe janë përkujdesur rregullisht për mirëmbajtje të pemishteve, nga edhe ka pasur një rritje dhe zhvillim të mirë të bimëve si dhe bimët kanë dhënë një prodhim simbolik që në vitin e parë.

Kultivimi i kornishonëve në veri

Në komunat në veri të Regjionit të Mitrovicës janë përkrahur fermerët nga komuniteti serb edhe në kultivimin e kornishonit në fushë të hapur në sistemin shpalir. Gjithsejtë janë furnizuar 10 fermerë me farëra hibride të kornishonit, plehra minerale, pesticide, pompa spërkatëse, folje të zezë, sistem të ujitjes pikë-pikë dhe rezervuar plastik me kapacitet prej 1000 L, si dhe me tel të zingtuar dhe rrjetë plastike për mbështetje të bimëve në sistemin shpalir. Edhe pse kushtet kanë qenë tejet të vështira për mbrojtje të bimëve nga sëmundjet, sidomos nga vrugu i kungulloreve, megjithatë fermerët kanë marrë mesatarisht nga 650 kg fruta të kornishonëve, si dhe kanë përvetësuar teknikën e kultivimit të kornishonit që do të ju mundësoj të vazhdojnë dhe rrisin sipërfaqet me këtë kulturë në vitet e ardhshme.



Kultivimi i bimëve aromatike mjekësore

Në projektin trevjeçar ECoFK një komponentë shumë e rëndësishme ka qenë edhe promovimi i kultivimit të bimëve aromatike mjekësore, ku IADK ka përkrahë fermerët me farëra apo fidanë dhe inpute tjera për prodhimin e llojeve të ndryshme të bimëve aromatike mjekësore. Në vitin 2012/2013 janë përkrahë fermerët në kultivimin e mëllagës së bardhë dhe mëllagës së zezë, dhe është bërë një tentim që të përkrahen edhe disa fermerë në zonën e Shalës së Bajgores për të kultivuar Gentianën, por për shkak gjatë prodhimit të fidanëve, farërat e kësaj bime kërkojnë një tretman të veçantë, kompania kontraktuese edhe pse ka qenë profesionale për këtë qëllim, ajo nuk ka arritur të bëjë prodhimin e fidanëve të Gentianës ngase bimët e sapo mbira kanë dështuar.

Në vitin 2014 janë përcjellë 5 fermerët përfitues në kultivimin e rignonit të bardhë, i cili është mbjellë në vjeshtën e vonë të vitit 2013, si dhe përkrahja e 6 fermerëve për kultivimin e sherbelës.



Kultivimi i sherbelës



Kultivimi i rignonit të bardhë

Përfituesit e rignonit të bardhë dhe sherbelës janë furnizuar me fidanë për mbjellje të ngastrave me sipërfaqeve prej 2000 m², pastaj me sistem të ujitjes pikë-pikë dhe me nga një serrë prej 50 m² me konstrukcion nga metali i zinkuar dhe mbulesë speciale nga plasmasi për terjen e bimëve pas korrjes.

Kultivimi i rignonit të bardhë te të pesë përfituesit është plotësisht i suksesshëm dhe gjatë vegjetacionit janë kryer dy kositje të bimëve. Prodhimi mesatar për përfitues ka qenë 800 kg masë e tharë e kërcejve, gjetheve dhe luleve të bimëve, ndërsa prodhimi më i lartë është arrit te një fermerë nga Istogu, i cili në dy kositjet e rignonit të bardhë ka marrë 1400 kg masë të tharë të bimëve të kositura. Kujdesi i mirë ndaj bimëve të rignonit të bardhë do t'u mundësojë fermerëve përfitues që edhe për 5-6 vite tjera të krijojnë të

ardhura të mira nga plasimi i rigonit i cili është dorëzuar në kompaninë grumbulluese me një çmim prej 1 €/kg, dhe se fermerët do të vetë inkurajohen për të zgjeruar sipërfaqet e mbjella me këtë bimë aromatike shumë të leverdishme.

Kultivimi i sherbelës është shtrirë në katër komuna, ku janë përkrahur 6 fermerë me fidanë të sherbelës të importuar nga Shkodra. Fermerët përfitues të sherbelës janë nga Komuna e Vushtrrisë -2, Mitrovicës -2, Skenderajt -1 dhe Drenasit -1. Mbjellja e fidanëve është realizuar nga 10-15 Maj 2014, ndërsa për shkak të reshjeve të shpeshta të shiut gjatë tërë vegjetacionit zënia e bimëve ka qenë e mirë, por rritja dhe zhvillimi i tyre i ngadalshëm ngase sherbela është një bimë shumë rezistuese ndaj thatësirave, por nuk i përshtaten shumë verërat me lagështi të madhe. Fermerët kanë kryer vetëm nga një korrije të bimëve dhe kanë marrë një prodhim simbolik të masës bimore të tharë në sasi nga 150-200 kg, të cilën e kanë plasuar në kompaninë grumbulluese me një çmim prej 1 €/kg. Edhe pse prodhimi këtë vit ka qenë simbolik, bimët kanë forcuar sistemin rrënjorë dhe kujdesi i duhur i fermerëve në vitet e ardhshme ndaj bimëve të kultivuara do të ofroj prodhimtari gjithnjë në rritje nga viti në vit ngase kjo është një bimë 10 vjeçare e cila nuk kërkon shpenzime të larta për mirëmbajtje dhe kultivim.

Shfrytëzimi i energjisë alternative

Investimet e bëra në vitin e kaluar në shfrytëzimin e energjisë diellore në bujqësi janë monitoruar edhe gjatë vitit 2014 dhe se fermerët e përfshirë në këto projekte me sukses janë duke e shfrytëzuar energjinë solare në pasterizimin e qumështit, pasterizimin e kavanozave me perime të konservuara, ujitjen e perimeve dhe tharjen e frutave malorë. Të gjithë përfituesit janë shumë të kënaqur e falënderues për përkrahjen që ju është dhënë ngase ky investim u ka ulë bukur mirë koston e prodhimit.

Ngritja e serave për prodhimin e perimeve

Në mbështetje të UNDP-së gjatë qershorit janë përkrahur 4 fermerë në pjesën jugore të Mitrovicës me nga një serrë me konstruksion nga metali i zingtuar me sipërfaqe prej 100 m². Përveç serrës fermerët janë përkrahur edhe me plehra minerale, folje të zezë sisteme të ujitjes pikë- pikë, fidanë të perimeve dhe disa inpute tjera. Fermerët përfitues kanë marrë edhe asistencë profesionale për praktikatat e rritjes së perimeve në serra. Edhe pse projekti është zbatuar paksa me vonesë në krahasim me vegjetacionin e perimeve prapë se prapë është arrit një prodhim i kënaqshëm i frutave të perimeve, ku mesatarisht secili fermer ka marrë nga 600 kg perime të ndryshme (spec, domate dhe tranguj), ndërsa në sezonin vjeshtorë fermerët janë përkrahur edhe me farëra të spinaqit për kultivim të dytë në serrë.



Ngritja e kapaciteteve të fermerëve në hortikulturë në komunat e rajonit veri dhe jug të Kosovës

Ky projekt u mundësua nga UNDP, ndërsa është financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Finlandës, dhe ka të bëjë me përkrahjen e fermerëve në sektorin e hortikulturës. Projekti ka shtrirje në regjionin jugor (Prizren, Dragash, Suharekë, Mamushë, Rahovec, Malishevë), dhe regjionin verior (Mitrovica e Veriut, Zubin Potok, Zveqan, Leposaviq), ndërsa do të realizohet në bashkëpunim me komunat e lartë cekura. Aktivitetet e projektit kanë filluar në muajin nëntor 2014 dhe do të vazhdojnë deri në Qershor të vitit 2015, nga do të përkrahen fermerët në ngritjen e serrave, ndërtimin e inkubatorëve për mbirjen e farërave të perimeve, ngritjen e plantacioneve me dredhëza, mjedra, si dhe kultivimin e bimëve mjekësore. Përveç përkrahjeve direkte do të ketë edhe trajnime profesionale, këshilla praktike në teren në lëmit përkatëse si dhe vizita studimore brenda dhe jashtë vendi. Së pari është filluar me aktivitetet në sektorin e perimekulturës, ku janë përzgjedhur 20 përfitues që vijnë nga Komuna e Prizrenit, Suharekës,



Mamushës, Rahovecit dhe e Malishevës, të cilët janë furnizuar me inpute të nevojshme për kultivim të perimeve, ndërsa te 10 përfitues është përfunduar montimi i konstruksionit të serrave, ndërsa montimi i serrave tjera dhe mbulesa me folje plasmasi do të bëhet në pranverën e hershme posa të përmirësohen kushtet klimatike. Serrat kanë sipërfaqe prej 200 m² dhe pas përgatitjes së tyre për mbjellje do të bëhet furnizimi edhe me fidanë të perimeve dhe do të ofrohen trajnime dhe këshilla praktike në teren me qëllim të arritjes së rezultateve sa më të mira në prodhimin e perimeve. Po ashtu janë instaluar edhe dy inkubator/dhoma për mbirjen e farërave të perimeve te dy prodhues të fidanëve të perimeve, njëri në veri dhe tjetri në jug të Kosovës, përkatësisht në Leposaviq dhe Rahovec, ndërkohë IADK në vitin 2015 do të vazhdoj bashkëpunimin me komunat ku shtrihet ky projekt për realizimin e aktiviteteve tjera.

Ngritja e pemishteve me mjedër në bashkëpunim me Komunën e Vushtrrisë

Në kuadër të bashkëpunimit të ndërsjellë që ka IADK me Komunën e Vushtrrisë gjatë vjeshtës së vitit 2014 janë pajtuar që të realizojnë një projekt të përbashkët në përkrahjen e fermerëve për mbjelljen e pemishteve me fruta të imëta përkatësisht me mjedër. Nga financimi i përbashkët i Komunës së Vushtrrisë, IADK-së dhe i fermerëve përfitues janë ngritur 4.5 ha me mjedër të kultivarit Polka, e cila do jep fruta në vitin e ardhshëm dhe do të ketë një periudhë të shfrytëzimit për së paku 15 vite. Në këtë aktivitet kanë përfituar 35 fermerë, 25 prej të cilëve kanë mbjellë nga 1000 m², dhe 10 fermerë kanë mbjellë nga 2000m² me mjedër. Paketa stimuluese për mbjellje të mjedrës ka përfshirë analizën për pjellshmërinë e tokës, fidanët e mjedrës, plehrat minerale, pompën stërpikse, sistemin e ujitjes pikë-pikë, gërrshërët dhe këshillat profesionale për teknikat e kultivimit të mjedrës.



Projekti me MATRA-në

Në kuadër projektit “Përkrahja e zhvillimit ekonomik dhe pajtimi në mes të fermerëve shqiptar, serb dhe të komuniteteve të ndryshme në veri të Kosovës” të përkrahur nga Ambasada e Mbretërisë Holandeze si përfitues kyç kanë qenë fermerët në sektorin e hortikulturës, gratë në aktivitetet e përpunimit shtëpiak të ushqimit dhe fermerët në sektorin e qumështit. Qëllimi i projektit ka qenë mbështetja e fermerëve në zhvillimin ekonomik dhe ri pajtim në mes komuniteteve nëpërmes trajnimeve, udhëtimeve studimore brenda dhe jashtë vendit të komuniteteve të përziera në sektorët e lartcekur. Si rezultat i realizimit të projektit janë trajnuar 52 gra në përpunimin shtëpiak të ushqimit, 39 fermerë në hortikulturë dhe 26 fermerë në sektorin e qumështit. Po ashtu janë realizuar edhe tri udhëtime të përbashkëta studimore brenda vendi dhe 2 udhëtime studimore në Serbi (Arile dhe Novi Sad), si dhe është publikuar një broshurë për përpunimin shtëpiak të pemëve, perimeve, qumështit dhe brumërave, bazuar në këmbimin e përvojave mes komuniteteve.



DEPARTAMENTI I BLEGTORISË

Përkrahja e fermerëve me makina mjelëse

Me qëllim të përmirësimit të kualitetit të qumështit dhe përkrahjes së ekonomive familjare që merren me blegtori, IADK gjatë këtij viti ka përkrahur 5 fermerë të komunitetit serb me makina mjelëse për lopë. Po ashtu fermerët janë përkrahur në gjetjen e tregut të qumështit, ku në kuadër të kësaj fermerët janë lidhur me pikat grumbulluese të qumështit të cilat IADK e ka ngritur në vitet paraprake.

Të gjithë përfituesit janë trajnuar në aspektin praktik në përmirësimin e kualitetit të qumështit dhe menaxhimit të fermave qumështore. Të gjithë përfituesit kanë arritur të përmirësojnë kualitetin e qumështit dhe kanë rritur të hyrat në fermat e tyre.



Shpërndarja e pajisjeve për bletari

Për të promovuar turizmin rural dhe sektorin e bletarisë në zonat rurale, gjatë vitit 2014, IADK ka përkrahur katër bletar të cilët merren me këtë sektor me pajisje si centrifuge për nxjerrjen e mjaltit, shkrirëse të dyllit, vaska për zhveshjen e hojeve dhe bidonë për mjaltë. Përfituesit janë zgjedhur në bashkëpunim me përfaqësuesit e komunave të Vushtrisë dhe Mitrovicës dhe janë përkrahur bletaret të cilët janë të orientuar në rritjen e numrit të koshereve të bletëve, porse nuk kanë pasur pajisjet adekuatë për rritjen e numrit të bletëve dhe aplikimit të teknologjive të reja. Përfituesit janë nga komuna: Vushtri (2), dhe Mitrovice (2). Pas përdorimit të pajisjeve bletaret janë deklaruar se tani kanë mundësi të rrisin numrin e koshereve të bletëve sepse puna është lehtësuar shumë, mjalti është i kualiteti me të lartë dhe kanë arritur të ulin koston e prodhimit të mjaltit sepse tani kanë mundësi që të bëjnë shkrirjen e dyllit vetë me pajisjet të cilat kanë përfituar.



Makina për përgatitjen e silazhit të Barit

Me qëllim të përmirësimit të kualitetit të ushqimeve voluminoze dhe rritjes së prodhimtarisë së qumështit, IADK gjatë vitit 2014 ka përkrahur 7 fermerë me makina për korren e silazhit të barit. Përfituesit e makinave të silazhit të barit janë nga komunat e Vushtrisë, Skenderajt, Mitrovicës, Drenasit dhe Podujevës. Të gjithë përfituesit gjatë këtij viti i kanë përdorur makinat e silazhit të barit në mënyrë të duhur dhe janë këshilluar dhe monitoruar nga ekspertët e IADK-së sepse për here të pare është bere promovimi dhe përgatitja e silazhit të barit në komunat përkatëse. Për këtë arsye, IADK ka organizuar trajnime teorike dhe praktike me të gjithë fermerët e interesuar dhe ka organizuar 7 ditë fushore në përgatitjen e silazhit të barit dhe janë trajnuar mbi 100 fermerë. Pas demonstrimit dhe trajnimeve që janë mbajtur fermerët kanë filluar të përgatisin silazhin e barit dhe të kryejnë shërbime edhe për fermerë të tjerë. Gjatë këtij viti mbi 25 fermerë, për here të pare kanë përgatitur silazh të barit të një cilësie shumë të mire.



Pas shfrytëzimit të makinave të silazhit në mënyrë adekuatë, kositjen e bimëve para lulëzimit dhe përgatitjes së silazhit të barit cilësor, fermerët kanë deklaruar se është rritur prodhimtaria e qumështit deri në 20 %.

Shpërndarja e boksave për rritjen e viçave

Në kuadër të projektit “Edukimi dhe Konsolidimi i Fermerëve të Kosovës”- ECoFK, gjatë vitit 2014 IADK ka përkrahur prodhuesit e qumështit me boksa për rritjen e viçave. Në kuadër të këtij projekti IADK ka përkrahur 11 fermerë me 28 boksave për rritjen e viçave. Përfitues të boksave për rritjen e viçave janë fermerët nga komunat e Vushtrisë, Mitrovicës, Skenderajt, Drenasit dhe Podujevës. Varësisht nga numri i lopëve fermerët kanë përfutur nga 2 dhe 3 boksa. Qëllimi i këtij projekti është krijimi kushteve për fermerët në rritjen e viçave në kushte sa më të mira me qëllim që fermerët të kenë mëshjtjerë të mira për reproduksion. Përparesitë e rritjes së viçave në boksa individual janë: parandalimin e infektimit të viçave nga burimet e ndryshme të infeksionit, ajrim dhe ndriçim i mjaftueshëm, kontrollimi konsumimit të ushqimit për secilin viç. Përfutuesit dhe fermerët tjerë janë trajnuar në mënyrë praktike në kujdesin ndaj viçave, të ushqyerit të viçave me kulloshtër dhe qumësht, të ushqyerit me ushqim voluminozë dhe të koncentruar. Trajnimet janë mbajtur nga ekspertët e IADK-së dhe ekspert nga Holanda dhe Franca, ku janë trajnuar 78 fermerë.



Implementimi i praktikave të mira në menaxhimin e pikave grumbulluese të qumështit

Gjatë vitit 2014 IADK ka vazhduar në implementimin e standardit të GMP në pikat grumbulluese të qumështit, ku këto praktika të mira janë zbatuar në 3 pika grumbulluese të qumështit. Pas implementimit të GMP pikat grumbulluese të qumështit kanë përmirësuar kualitetin e qumështit dhe është rritur mirëbesimi në mes të prodhuesve dhe përpunuesve të qumështit. Deri më tani, IADK ka përkrahur gjashtë pika grumbulluese të qumështit në implementimin e praktikave të mira të menaxhimit (GMP).

Organizimi i vizitës së fermerëve kultivues të deleve dhe dhive në Shqipëri

Për të shkëmbyer përvojat me fermerët nga Shqipëria të cilët janë kultivues të deleve dhe dhive, IADK gjatë vitit 2014 ka organizuar një vizitë studimore në Shqipëri ku kanë marrë pjesë 8 fermerë. Qëllimi i kësaj vizite ka qenë që fermerët nga Kosova të njihen me eksperiencat e fermerëve nga Shqipëria dhe të bëhet shkëmbimi i përvojave të tyre. Vizita u mbajt në Regjionin e Korçës dhe Pogradecit. Pjesëmarrësit e vizitës janë njohur me përvojën e shoqatave, funksionimin e tyre, qëndrueshmërinë e shoqatës, menaxhimin e fermave, të ushqyerit, seleksionimin për reproduksion, preventiven ndaj sëmundjeve të ndryshme, procedurat e përpunimit të qumështit, llojet e djathërave dhe marketingun e produkteve të deleve dhe dhive.



Shkëmbimi i përvojave me organizatën AFDI nga Franca

Edhe gjatë vitit 2014 ka vazhduar bashkëpunimi me shoqatën AFDI në shkëmbimin e përvojave në sektorin e bujqësisë. Gjatë vitit 2014 përfaqësuesit e AFDI-të kanë realizuar një vizitë në Kosovë. Qëllimi i vizitës ka qenë që t'u ndihmohet fermerëve në menaxhimin sa më të mirë të fermave, balancimin e racioneve ushqimore, përgatitjen e silazhit të barit dhe rritjen e mëshjtjerrave për reproduktim. Me qëllim të shkëmbimit të përvojave, IADK ka organizuar një vizitë studimore në Francë ku kanë marrë pjesë dy përfaqësues nga organizata e IADK, një përfaqësues nga Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe një fermerë. Qëllimi i vizitës ka qenë në shkëmbimin e përvojave në sektorin e bujqësisë më konkretisht në organizimin e shërbimeve këshillimore, organizimin e fermerëve, trajnimin e

fermerëve lider dhe kontrollin e cilësisë së qumështit. Gjatë vizitës studimore janë realizuar shumë takime të ndryshme si me Odat e bujqësisë, institute të cilat merren me hulumtime, qendrat trajnuese për fermerët e rinj, qendrat e identifikimit të kafshëve, takim me përfaqësuesit e Ministrisë së Bujqësisë, shkolla të mesme bujqësore nga sektori privat dhe shtetëror, disa qendra hulumtuese dhe informuese për fermerët, ferma për prodhimin e qumështit, prodhues të perimeve bio dhe takime me kompanitë të cilat japin shërbime këshillimore për fermerë.

Ekspertët Seniorë të PUM nga Holanda

Në sektorin e blegtorisë gjatë vitit 2014 është angazhuar një ekspert i bletarisë nga organizata PUM. Gjatë këtij misioni bletarët janë trajnuar dhe janë këshilluar rreth sëmundjeve të bletëve dhe parandalimin e sëmundjeve, mënyrën e trajtimit të bletëve me preparate që nuk shkaktojnë mbetje në mjaltë, të ushqyerit e bletëve edhe përgatitjen për dimërim dhe shfrytëzimin e bletëve për polenizimin e bimëve.



Përkrahja e fermerëve në rritjen e zogjve për majmëri – Brojlerëve

Gjate këtij viti është përkrahur një fermerë në rritjen e zogjve për majmëri në komunën e Mitrovicës. Qëllimi i këtij aktiviteti ka qenë përmirësimi i kushteve për rritjen e zogjve për majmëri dhe promovimin e këtij sektori me qëllim që edhe fermerët tjerë të merren me rritjen e zogjve për majmëri. Gjate këtij viti ky fermerë ka rritur 1800 zogj për majmëri.

Organizimi i fermerëve

Në kuadër të projektit “Edukimi dhe Konsolidimi i Fermerëve në Kosovë 2012-2014” IADK ka ndihmuar fermerët të themelojnë organizatën e fermerëve në nivelin më të lartë të përfaqësimit të interesave të tyre, e cila është themeluar nga bashkimi i shoqatave të fermerëve nga sektorë të ndryshëm të bujqësisë nga komuna të ndryshme të Kosovës, dhe njihet me emrin Bashkimi i Shoqatave Bujqësore të Kosovës (BSHBK).

Në fillim të 2014 gjegjësisht në muajin janar IADK së bashku me BSHBK kanë organizuar ngjarjen promovuese të BSHBK-së ku kanë marrë pjesë 36 pjesëmarrës nga palët e interesit; IADK, BSHBK, Ambasada Turke, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovës, Oda turko-kosovare, UNDP, Solidar Suiss, GIZ, OEK, Pestova, MBPZHR, Gratë për Gratë internacional, ku është diskutuar tema: “Bashkëpunimi dhe koordinimi i aktiviteteve të BSHBK-së me institucionet relevante dhe me palët tjera të interesit”. Anëtarët e BSHBK-së kanë marrë pjesë në grupet punuese të MBPZHR ku kanë kontribuar në përpilimin e kriterëve për subvencione dhe grante por edhe në zhvillimin e strategjisë së MBPZHR-së 2014-2020.

IADK ka organizuar pakon e trajnimeve në aspektin menaxherial e cila paketë ka përmbytur 12 sesione të trajnimeve ku kanë marrë pjesë 121 anëtarë të bordit të BSHBK-së në përgjithësi.

Gjate këtij viti është realizuar misioni i ekspertit nga Holanda i cili mision ka pasur për qëllim informimin e BSHBK-së lidhur me Bashkëpunimi në mes të institucioneve dhe Federatave të Fermerëve në Holandë, si i qasen Federatat e fermerëve në Holandë anëtarëve të vet dhe marrja e këtyre përvojave dhe zbatimi në Kosovë (nga BSHBK).



Në kuadër të kësaj komponentë është organizuar vizitë 3 ditore në Maqedoni ku kanë marrë pjesë anëtarët e Ombrellës së shoqatave të grave, e cila ombrellë është pjesë e Bashkimit të Shoqatave Bujqësore të Kosovës. Kjo vizitë është organizuar me qëllim të përfitimit të njohurive nga fusha e organizimit të shoqatave të grave si dhe përpunimit shtëpiak e posaçërisht njohjes me përvojat e grave nga Maqedonia në prodhimin e produkteve të përpunuara dhe marketingun e tyre.

Një nga mjetet për promovim të BSHBK është edhe fletëpalosja prandaj këtë vit IADK ka përkrahur me publikimin e një fletëpalosje të BSHBK-se me informatat bazike të kësaj shoqate.



DEPARTAMENTI I PËRPUNIMIT TË USHQIMIT

Në kuadër të këtij departamenti edhe në vitin 2014 fokusi kryesor ka qenë ngritja e aftësive të grave për përpunimin e prodhimeve bujqësore përmes organizimeve të trajnimeve grupore në zonat rurale në komuna të ndryshme të Kosovës. Gjatë trajnimeve janë demonstruar praktikat dhe teknologjitë e ndryshme të përpunimit shtëpiak të prodhimeve blegtorale, pemëve dhe perimeve, si dhe mënyrat e gatimit të ushqimeve tradicionale, me qëllim të prodhimit të produkteve me kualitet të lartë e të orientuar për tregun lokal dhe më gjerë.

Departamenti i përpunimit ka organizuar kurse të trajnimeve në përpunimin e qumështit për grupe të grave. Në kuadër të tri projekteve të ndryshme të cilat IADK i ka zbatuar gjatë këtij viti, janë trajnuar 3 grup të grave në përpunimin e qumështit me gjithsej 93 gra nga komuna e Mitrovicës dhe e Vushtrrisë. Moduli trajnues për përpunim të qumështit ka përmbytur 20 sesione, gjatë të cilave gratë janë trajnuar në prodhimin e 13 llojeve të ndryshme të djathit. Po ashtu janë për secilin grup mbajtur nga 5 sesione të trajnimeve në aspektin ekonomik të biznesit të fermës.

Trajnimet për përpunim të qumështit

Meqenëse qumështi është produkti më kryesorë në zonat rurale, i cili prodhohet në fermat blegtorale dhe ka një konsum të gjerë nga popullata qoftë si i freskët apo edhe i përpunuar, departamenti i përpunimit ka organizuar kurse të trajnimeve në përpunimin e qumështit për grupe të grave. Në kuadër të tri projekteve të ndryshme të cilat IADK i ka zbatuar gjatë këtij viti, janë trajnuar 3 grup të grave në përpunimin e qumështit me gjithsej 93 gra nga komuna e Mitrovicës dhe e Vushtrrisë. Moduli trajnues për përpunim të qumështit ka përmbytur 20 sesione, gjatë të cilave gratë janë trajnuar në prodhimin e 13 llojeve të ndryshme të djathit. Po ashtu janë për secilin grup mbajtur nga 5 sesione të trajnimeve në aspektin ekonomik të biznesit të fermës.



Trajnimet për përpunimin e pemëve

Gjatë vitit janë organizuar edhe kurse grupore të trajnimeve të grave në zonat ku ka pas më tepër plantacione të pemëve, ku në kuadër të tri projekteve të ndryshme janë mbajtur nga 20 sesione trajnuese në përpunimin e pemëve dhe nga 5 sesione të trajnuese për aspektin ekonomik të fermës për secilin grup. Këto trajnime i kanë ndjekë 46 gra pjesëmarrëse nga komuna e Drenasit,



Mitrovicës dhe Vushtrrisë. Si rezultat i këtyre trajnimeve gratë janë aftësuar në përpunimin e pemëve në marmelatë, xhemë dhe reçel nga pemë të ndryshme. Disa trajnime praktike janë mbajtur në pikën përpunuese në fshatin Broboniq dhe Frashër të komunës së Mitrovicës, të cilat shërbejnë edhe si pika demonstruese për grupet e grave.

Trajnime në përpunimin e perimeve

Edhe prodhimi i perimeve është një sektorë mirë i zhvilluar në Kosovë dhe në fshatra të caktuara shumë fermerë merren me kultivimin e perimeve në fushë të hapur apo edhe në mjedise të mbrojtura. Për këtë arsye janë organizuar kurse të trajnimeve me tri grupe të grave për përpunim të perimeve, të cilat janë mbajtur në tri komuna të ndryshme, ku IADK ka shtrirje me aktivitete të ndryshme. Kurset trajnuese janë organizuar në fshatin Batllavë të komunës së Podujevës, në fshatin Bajgorë të komunës së Mitrovicës dhe në fshatin Sfaraqak i Ulët të Vushtrrisë, dhe si rezultat 54 gra janë aftësuar në përpunimin/konservimin e llojeve të ndryshme të perimeve, në ajvar, pingjur, sallata dhe turshi të ndryshme. Gratë pjesëmarrëse në këtë kurs kanë ndjekë edhe 5 sesione trajnuese për anën ekonomik të biznesit, mbajtjen e shënimeve, menaxhimin e biznesit të fermës, koston e prodhimit dhe marketingun.



Më 15 Dhjetor 2014 është mbajtur ngjarja “Certifikimi i grupeve të grave dhe fermerëve” ku 54 gra nga këto 3 grupe janë certifikuar për përfundimin me sukses të këtyre trajnimeve.

Disa nga gratë e përfshira në trajnimet nga projekti “Promovimi i shërbimeve të turizmit rural dhe infrastrukturës në zonën e Shalës” janë përkrahur edhe me pajisje bazike për prodhimin e djathit, turshive, xhemëve dhe ushqimit tradicional, varësisht se cilin kurs trajnimi kanë ndjekur.

Promovimi i produkteve

Promovimi i produkteve ka vazhduar me pjesëmarrje në panaire të ndryshme ku IADK ka organizuar në bashkëpunim me institucione të tjera.

1. Panairi i organizuar nga IADK në bashkëpunim me Komunën e Prishtinës në Sheshin “Zahir Pajaziti” – Shkurt 2014, të pranishme gjatë 4 ditëve ishin 44 gra
2. IADK në bashkëpunim me organizatën Gratë për Gratë, ka përkrahë gratë në promovimin e produkteve në Sheshin “Zahir Pajaziti” në Prishtinë, po ashtu në muajin Shkurt 2014, ku të pranishme gjatë ditëve në panair ishin 8 gra/klientë të IADK-së dhe kanë bërë shitjen e produkteve në vlerë prej 3,323.00€.
3. Panairi i produkteve bujqësore-MBPZHR dhe OEK
4. Panairi regjional për bujqësi “Mitrovica 2014

Është bërë njoftim në radion lokale “Radio Drenica” për promovimin e produkteve të grave.

Po ashtu gjatë muajit tetor 2014 gratë kliente të IADK-së kanë filluar të shesin produktet e tyre edhe në pikën shitëse në Mitrovicë, e cila është përkrahur me inventar për ekspozimin dhe ruajtjen e produkteve.



Krijimi i pikës përpunuese për pemë dhe perime

Për të shtuar vlerën e prodhimeve bujqësore, dhe përpunimin tyre në kohën kur tregu nuk ofron çmime të favorshme për shitjen e pemëve, e sidomos perimeve të freskëta dhe me qëllim të krijimit të kushteve për biznese të vogla në ekonominë familjare IADK edhe



këtë vit ka ndihmuar me pajisje për përpunim dhe ruajtje të prodhimeve bujqësore një fermere nga fshati Bradash i komunës së Podujevës. Pronarja e kësaj pike përpunuese ka filluar me prodhimin e 11 llojeve të ndryshme të produkteve të përpunuara, dhe gjatë periudhës 5 mujore prej se ka filluar përpunimin e pemëve dhe perimeve ka bërë shitje në vlerë prej 6,471.00 €.

Tryezë e rrumbullakët me partnerët në zinxhirin e vlerave për ushqimin e përpunuar shtëpiak

Gjatë muajit Maj 2014 IADK ka organizuar tryezën e rrumbullakët me temë “Bashkëpunimi në mes të anëtareve të ombrellës dhe grave që merren me përpunimin shtëpiak me palët e interesit në sektorin e përpunimit shtëpiak”

Në këtë tryezë kanë marrë pjesë 20 pjesëmarrës nga të gjitha palët e interesit, prodhues të pemëve dhe perimeve, përpunuesit e ushqimit, dhe konsumator.

Përcjellja e të gjitha njësive të themeluara të përpunimit

Edhe gjatë këtij viti pronaret e gjashtë pikave përpunuese të themeluar nga IADK gjatë viteve 2010-2014 janë përcjellë dhe përkrahur në zhvillimin e biznesit të tyre. Pikat përpunuese dhe gratë aktive në treg kanë zhvilluar aktivitetet e tyre ku gjatë sezonës së shitjes kanë bërë shitje të produkteve të përpunuara në vlerë prej 60,248.90€.

Krijimi i shoqatave të grave

Këtë vit janë përkrahur dy grupe të grave nga komuna e Podujevës në themelimin e dy shoqatave të tyre, dhe atë në fshatin Bradash është themeluar Shoqata “Puntorja e Llapit”, ku kjo shoqatë është përkrahur edhe me pajisjet për zyrë të shoqatës, ndërsa në fshatin Batllavë është përkrahur themelimi i shoqatës “Begotitë e Batllaves”. IADK ka përkrahur këto dy shoqata gjatë gjithë procesit të përgatitjes së dokumenteve për regjistrim dhe ka ndihmuar në përgatitjen e statutit të shoqatës, logon si dhe në zgjedhjen e organeve të shoqatës.

Përmirësimi i kualitetit të prodhimeve dhe standardizimi

Me qëllim të përmirësimit të kualitetit të produkteve të përpunuara nga gratë si dhe standardizimit të këtyre produkteve janë zhvilluar disa aktivitete, ndër të cilat janë:

a) Misioni i konsulentit të PUM-it nga Holanda i cili mision është realizuar gjatë muajit gusht. Qëllimi i këtij misioni ishte fokusuar këto çështje:

- Dhënia e këshillave teknike për sektorin e përpunimit të ushqimit
- Përgatitja e llojeve të ndryshme të bukës dhe mishit

Po ashtu gjatë muajit nëntor në pikat përpunuese të krijuara nga IADK është marrë nga një mostër (gjithsejtë 6 mostra) për analizë, e cila është bërë në Institutin e Shëndetësisë Publike të Kosovës.

Rezultati i Analizave të testuara “si nga ana mikrobiologjike ashtu edhe nga aspekti fiziko-kimik të të gjitha mostrat janë brenda normativave të parapara për konsum si në aspektin e cilësisë ashtu edhe atë të sigurisë dhe nuk kanë prani të tharimeve dhe myqeve apo përbërës të huaj, primesa të dyshimta, baktere dhe të gjitha mostrat janë në pajtim me Ligjin e ushqimit Nr. 03/L-16 “.

Me qëllim të standardizimit dhe krijimit të më shumë mundësive për shitjen e produkteve të përpunuara nga ana e grave, IADK ka siguruar barkodet nga Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) si dhe ka përkrahur me etiketa këto shoqata :

- Shoqatën “Vullneti i grave”, fshati Studime, Vushtrri
- Shoqata “Punëtorja e Llapit”, fshati Bradash, Podujevë
- NP “Sofra”, fshati Frashër, Mitrovicë dhe
- NP “Doroci”, fshati Broboniq, Mitrovicë.

Ngritja e kapaciteteve dhe fuqizimi ekonomik i grave kryefamiljare

Edhe këtë vit IADK ka vazhduar aktivitetet për fuqizimin dhe ngritjen e kapaciteteve të grave kryefamiljare në regionin e Mitrovicës. Në bashkëpunim me komunën e Vushtrisë janë përkrahur dy gra të komunës së Vushtrisë me pajisje të nevojshme për krijimin e një pike për përgatitjen e ushqimeve për nxënësit e



shkollës fillore “Lumni Surdulli”. Po ashtu gjatë vitit janë përcjell pikat tjera për përgatitje të ushqimit për nxënës ku gjatë kësaj periudhe këto gra kryefamiljare kanë bërë shitje në vlere prej 34,522.24 euro.

Televizioni KTV ka përgatitur një reportazh për grupin i grave kryefamiljare të cilat punojnë në shkollën “Andon Zako Çajupi” në Vushtrri i cili reportazh është emituar në muajin Nëntor në emisionin Sot. Poashtu gazeta ditore “Koha ditore” e datës 16 Nëntor ka publikuar një artikull me titull “Kuzhinieret që sfidojnë paragjykimet” në të cilën paraqitet përkrahja e IADK-së që i ka dhënë këtij grupi të grave si dhe puna e këtyre grave.

Komuna e Vushtrrisë në çdo ngjarje dhe aktivitete të saja angazhon këtë grup të grave për përgatitjen e ushqimeve tradicionale.

Fuqizimi i grave në sektorin e bujqësisë dhe krijimi i lidhjeve me tregun

Gjatë vitit 2014 IADK ka nënshkruar kontratë me Ambasadën Kanadeze për realizimin e një projekti afat shkurtër (4 mujorë) por me një ndikim shumë të madh në sektorin e blegtorisë dhe përpunimit të qumështit, i cili ka filluar në Nëntor 2014 dhe do të përfundojë në shkurt 2015.

Projekti synon në fuqizimin e grave në zonat rurale përmes aktiviteteve në sektorët e përpunimit të qumështit dhe blegtorisë dhe do të ketë ndikim pozitiv në të ardhurat që gjenerojnë si rezultat i rritjes së produktivitetit në fermë dhe vlerën e shtuar të qumështit përmes përpunimit të qumështit në djathë dhe produkte të tjera. Projekti "Fuqizimi i grave në sektorin e bujqësisë dhe krijimi i lidhjeve me tregun" do të përfshijë drejtpërdrejt 30 gra që jetojnë në zonat e largëta rurale, ku kontributi i grave në sektorin e blegtorisë është shumë i rëndësishëm.

Po ashtu gratë pjesëmarrëse në trajnime do të përkrahen me nga 1 (një) makinë mjelëse dhe pako higjienike për pastrim.



Bashkëpunimi me RrGGK dhe partnerët tjerë në Kosovë

Në vazhden e bashkëpunimit në mes të RrGGK –së dhe IADK janë organizuar 3 sesione të trajnimeve në aspektin shëndetësor me temë “Kanceri i gjirit dhe mitrës”, pasi edhe ka qenë muaji i luftës kundër kancerit, ku kanë marrë pjesë 79 gra nga grupe të ndryshme të grave si dhe gra të veja nga komuna e Vushtrrisë. Këto trajnime janë mbajtur nga shoqata “Dera e Hapur” e cila shoqatë është anëtare e RrGGK-së.

Po ashtu gjatë korrikut janë organizuar dy ditë trajnimi të planifikuara nga Rrjeti i grave të Kosovës për fermeret e IADK-së. Temat e trajnimit: Fuqizimi i gruas dhe menaxhimi i konflikteve, ku kanë marrë pjesë 31 gra nga komuna e Mitrovicës dhe Vushtrrisë.



Vizitë në Kosovë

Në kuadër të departamentit të përpunimit të ushqimit janë realizuar 2 vizita në Kosovë; njëra vizitë është realizuar nga projektit i financuar nga BE “Promovimi shërbimeve të turizmit rural dhe infrastrukturës në zonën e Shalës ku 85 gra kanë pasur mundësi të njoftohen me punën e grave të regjioneve tjera si dhe shkëmbimin e përvojave në mes tyre, ndërsa vizita e dytë është bërë në kuadër të projektit MATRA (“Përkrahja e zhvillimit ekonomik dhe pajtimi në mes të fermerëve shqiptar, serb dhe të komuniteteve të ndryshme në veri të Kosovës,” projekt i përkrahur nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës ku gratë nga komunitet të ndryshme kanë pasur



mundësi të shkëmbejnë përvojat por edhe njohja në mes veti dhe mundësia e bashkëpunimit në të ardhmen.

Promovimi shërbimeve të turizmit rural dhe infrastrukturës në zonën e shalës

Në kuadër të projektit të financuar nga BE-ja “Promovimi i shërbimeve të turizmit rural dhe infrastrukturës në zonën e Shalës”, i realizuar në partneritet me Komunën e Mitrovicës dhe Komunën e Vushtrrisë, i cili ka filluar në vitin 2013 me disa aktivitete të cilat kanë pas vazhdimësi edhe në vitin 2014, janë në përfshirë në katër komponente më kryesore, siç janë:

- Ndërtimi i shtegut për këmbësorë, biçikleta dhe vend-pushimeve për vizitorë,
- Promovimi i energjisë alternative dhe restaurimi i mullirit tradicional,
- Rritja e prodhimit të bujqësore dhe përmirësimi i kualitetit të produkteve bujqësore,
- Ngritja e kapaciteteve menaxhuese të fermerëve dhe përmirësimi i shërbimeve për turizëm rural.

Në vitin 2014 janë realizuar aktivitetet e mëposhtme:

- Vazhdimi i ndërtimit të shtegut për këmbësorë dhe biçikleta,
- Ndërtimi i kroit të pestë për ujë të pijshëm përgjatë shtegut,
- Rritja e kualitetit dhe variacioneve të shërbimeve turistike,
- Promovimi i energjisë të prodhuar nga uji,
- Përkrahja e mullirit tradicional të restauruar në vitin e kaluar,
- Restaurimi edhe i tri odave (bujtinave) tjera tradicionale dhe promovimi i atyre të vitit të kaluar,
- Pajisja e dy restoranteve me biçikleta malore për vizitorë dhe turistë,
- Fuqizimi i rolit të femrave në zonat rurale, përmes ngritjes së kapaciteteve në sektorin e punimit të ushqimit,
- Vazhdimi i përkrahjes së fermerëve në zhvillimin e ekonomisë së gjelbër në zonat rurale, përmes prodhimit të perimeve në serra dhe pemishteve prezervuese,
- Përkrahja e fermerëve me pajisje për zhvillimin e bletarisë,
- Shkëmbimi i eksperiencave me zonat tjera për turizëm rural,
- Vizita studimore në zona tjera të përparura të turizmit në Kosovë dhe në regjionin për rreth,
- Publikimi i fletëpalosjeve, broshurave dhe katalogëve.

Shtegu për këmbësor dhe biçikleta

Ky aktivitet ka pas një vazhdimësi të punëve gjatë vitit 2014, pasi që për shkak të kushteve klimatike nuk ka qenë e mundur të përfundohen punimet në vjeshtën e vitit të kaluar. Shtegu ka një gjatësi prej 10 km dhe kolon nëpër fshatra të dy komunave në zonën e Shalës. Ky shteg ka filluar të shfrytëzohet nga ana e këmbësorëve dhe çiklistëve, të cilët frekuentojnë gjatë ditëve të freskëta të verës për të shijuar peizazhet e bukura të zonës së Shalës, e që shërben për mbajtjen e kondicionit të mirë shëndetësor.



Ndërtimi i krojeve

Në vitin e kaluar janë ndërtuar katër kroje në lokacione të ndryshme përgjatë shtegut, ndërsa me kërkesë të banorëve të fshatit Gumnishtë dhe vizitorëve që frekuentojnë këto pjesë, Po ashtu IADK këtë vit ka ndërtuar edhe një krua në hyrje të fshatit Gumnishtë. Krojet, përveç që kanë burimet natyrore me ujë të freskët për pirje dhe freskim, aty vizitorët kanë mundësi edhe të pushojnë, apo edhe të konsumojnë ushqimet të cilat i kanë marrë me veti gjatë shetitjeve në zonën e fshatrave ku janë ndërtuar shtigjet e

ecjes. Gjithashtu krojet mund të shfrytëzohen edhe nga popullata e atyre zonave rurale gjatë kalimeve që ata i bëjnë në lëvizjet gjatë punëve në bujqësi, blegtori apo në pyjet e tyre.

Përkrahja e mullirit të restauruar

Mulliri me ujë i restauruar në vitin e kaluar në fshatin Samadrexhë, ka vazhduar të ofrojë mundësi të mira për rritjen e të hyrave për ekonominë familjare të përfituesit, por ka shërbyer edhe si një atraksion për vizitorët dhe klientët të cilët dëshironin të shërbehen me miell misri të kualitetit të lartë. Ambienti i jashtëm para mullirit, pamja e tij, veranda, rrjedha e ujit etj., janë një peizazh i këndshëm për të gjithë ata kalimtar që lëvizin pranë tij. Për të përmirësuar marketingun e këtij biznesi, gjatë këtij viti IADK i ka ofruar përfituesit dy lloje të thasëve për paketimin e miellit, dhe atë në sasi 2 dhe 5 kg, me logot dhe të dhënat identifikuese të përpunuesit, si dhe një makinë për qepjen e thasëve. Pronari i mullirit, përveç që është vizituar nga klientët e ndryshëm dhe vizitorët tjerë, puna dhe funksionimi i tij është prezantuar edhe në media, që ka jep rezultate dhe ka pas një efekt shumë të mirë promovues, duke sjellë edhe klientë të rinj nga komuna të ndryshme të Kosovës. Në sajë të punës së palodhshme që bënë familja, korrektësisë dhe përkrahjeve që i është dhënë nga ky projekt, janë rritur kërkesat për furnizim të marketeve dhe konsumatorëve tjerë me miell misri nga ky biznes.



Prodhimi i energjisë alternative

Gjatë këtij viti është investuar në instalimin e një turbine për prodhimin e energjisë elektrike, e cila shërben për prodhimin e rrymës nga rrjedha e ujit të lumit në fshatin Sllakofc. Ky aktivitet ka pasur për synim promovimin e energjisë alternative në zonën e Shalës, si një atraksion për turistë duke instaluar një turbinë për prodhimin e energjisë nga uji në kapacitet prej 12.5 KW. Turbina e instaluar është funksionale dhe prodhon energji nga burimi i ripërtërishëm (uji), për nevojat e restorantit “Trofta e Lumit” në fshatin Sllakoc. Turbina në të njëjtën kohë është edhe një atraksion turistik që synon edukimin e vizitorëve për mundësitë e energjisë alternative, si dhe promovimin e energjisë së ripërtërishme, si një synim që duhet arritur në të ardhmen dhe duhet shfrytëzuar sa më tepër në Kosovë.



Restaurimi i odave (bujtinave) për turistë

Në vitin e kaluar janë restauruar tri oda (bujtina), të cilat janë të dizajnuar dhe projektuar nga zyrtarët e IADK-së për t'u dukur si oda (bujtina) tradicionale, por edhe për të qenë komod në të njëjtën kohë për vizitorët. Përfituesit e këtyre odave që vijnë nga fshatrat Bajgorë, Bare dhe Sllakofc, kanë filluar të shfrytëzojnë këto investime për akomodimin e vizitorëve dhe ofrimin e ushqimeve tradicionale, prej të cilëve më e vizituara dhe tërheqëse gjatë vitit 2014 ka qenë ajo në Bajgorë. Në kuadër të kësaj komponente gjatë këtij viti janë restauruar edhe tri oda tjera në fshatrat Bare, Gumnishtë dhe Sllakofc, të cilat po ashtu ofrojnë të njëjtat shërbime. Me qëllim të shfrytëzimit të drejtë të këtyre investimeve, përfituesit janë trajnuar për shërbime turistike, por edhe për aspektin ekonomik të tyre, duke reklamuar se akomodimi dhe asistimi i përfituesit bëhet në kuadër të gjithë procesin e mikpritjes për turistët.



Shpërndarja e biçikletave malore

Me aktivitetin e shpërndarjes së biçikletave janë përkrahur dy restorante, në Sllakofc dhe Bajgorë me nga 20 biçikleta malore. Qëllimin i këtij aktiviteti ka qenë diversifikimit të shërbimeve turistike, në pjesët ku ka shtrirje projekti për promovimin të shërbimeve të turizmit rural në zonën e Shalës. Biçikletat kanë një rol me dobi të dyanshme për pronarët e restoranteve, ngase do të shtojnë numrin e klientëve të tyre, por do të kenë edhe dobi për përdoruesit e biçikletave. Vizitorët të cilët kalojnë nëpër shtigjet e ecjes, kur arrijnë te restorantet, kanë mundësi të çlodhen dhe më pastaj mundë të marrin biçikletat me një pagesë simbolike për shfrytëzim brenda orëve të caktuara apo edhe tërë ditës. Gjithashtu ata mund të lëvizin më lehtë nëpër zonat më të largëta malore të Shalës, me qëllim të relaksimit dhe ndikimit pozitivë për një shëndet më të mirë. Përveç biçikletave, të dy restorantet janë furnizuar edhe me pajisje për përmirësim të infrastrukturës në kuzhinat e tyre.



Shenjëzimi i shtigjeve për ecje dhe çiklizëm

Për të lehtësuar orientimin e vizitorëve të cilët duan të kalojnë në zonat ku është zbatuar projekti, IADK ka punuar dy harta të mëdha të cilat janë vendosur në fillim dhe në përfundim të shtegut të ecjes. Njëra hartë është vendosur në hyrje të fshatit Sllakofc në zonën e Vushtrisë ku fillojnë shtrirjen aktivitetet e ndryshme të projektit, ndërsa harta tjetër është vendosur në hyrje të fshatit Bare në zonën e Mitrovicës. Në të dy hartat vizitorët pavarësisht se nga cila zonë dëshirojnë të fillojnë të lëvizin, e kanë shumë të lehtë të orientohen për shtegun e ecjes, vendndodhjet e restoranteve, odave(bujtinave), krojeve, mullirit me ujë, urës, turbinës, etj. Po ashtu janë vendosur edhe tabela tjera treguese në vende të caktuara, të cilat informojnë dhe orientojnë vizitorët për aktivitetet e caktuara apo për shërbimet që mundë t'i gjejnë në ato vise.



Vizita studimore në regjionet tjera të avancuara në Kosovë dhe regjion

Me qëllim të shkëmbimit të përvojave nga biznese të ngjashme turistike, janë organizuar vizita studimore brenda dhe jashtë vendit. Përveç vizitës së vitit të kaluar në regjionin e Pejës, këtë vit janë realizuar vizita në Novobërdë, Viti e Gjakovë, si dhe një vizitë në Theth të Shqipërisë.

Në vizitën e bërë në Novobërdë morën pjesë 17 persona, ku fillimisht u vizitua Qendrën e Informatave për Turistë, për të vazhduar pastaj me eksplorimin e atraksioneve, si: kalaja, xhamia, kisha dhe atraksione tjera për turistë. Vizita përfundoi me shijimin e ushqimit tradicional, të cilin e kishin përgatitur gratë e trajnuara për përgatitjen e ushqimeve tradicionale.



Në vizitat e bëra në Viti dhe Gjakovë morën pjesë 65 gra, të cilat vizituan një pikë përpunuese të qumështit dhe një pikë përpunuese të frutave. Këto vizita u realizuan për grupin e grave që janë trajnuar për përpunim të ushqimit, qumështit, perimeve dhe pemëve.

Në kuadër të projektit është realizuar edhe vizita e paraparë në regjion, ku u zgjodh të vizitohet Thethi i Shqipërisë me 15 pjesëmarrës, të cilët përveç bukurive të mrekullueshme të Thethit, përjetuan edhe

mikpritjen në zonat e thella rurale turistike, Me këtë rast u shijuan ushqimet, si dhe u bë akomodimi në bujtinat e Thethit. Pjesëmarrësit patën rastin të vizitojnë edhe Syrin e Kaltër dhe Kullën e ngujimit.

Trajnimet dhe monitorimet

Edhe gjatë vitit 2014 janë organizuar trajnime, këshilla praktike profesionale dhe janë monitoruar përfituesit e përmishteve tradicionale dhe serrave, pastaj përfituesit e pajisjeve në sektorin e blegtorisë, si dhe trajnime nga aspekti ekonomik për të gjithë përfituesit nga aktivitetet e ndryshme të këtij projekti.

Ueb Faqja

Është zhvilluar dhe lëshuar në funksion për turistët e interesuar një ueb faqe, ku të interesuarit mund të mësojnë rreth zonës së Shalës. Ueb faqja përmban informata për të gjithë projektin dhe për të gjitha mundësitë e turizmit që kjo zonë ofron. Ueb faqja është: www.shalatourism.org

Ngjarjet Promovuese

Gjatë zbatimit të këtij projekti dyvjeçar janë organizuar tri ngjarje promovuese, ku në ngjarjen e parë të mbajtur në vitin 2013 është promovuar projekti dhe objektivat së bashku me aktivitetet. Ngjarjet e dytë dhe e tretë janë mbajtur gjatë vitit 2014, ku ngjarja e dytë u karakterizua me përrurimin e odave (bujtinave), turbinës dhe shtegut për këmbësorë e biçikleta. Kjo ngjarje u përcjellë edhe nga mediumet lokale dhe nacionale. Në këtë ngjarje mori pjesë gjithashtu edhe Christof Stock, shef i marrëdhënieve në Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë, Bajram Mulaku, Kryetar i Komunës së Vushtrrisë dhe Safet Kamberi, Nënkrjetar i Komunës së Mitrovicës.

Ngjarja e tretë që ishte edhe ngjarje përmbyllëse, shënoi përfundimin e projektit dhe të gjitha aktivitetëve projektit, që u mbajt në Hotel Emerald së bashku me projektin tjetër të BE-së për Shoqëri Civile, i cili gjithashtu ishte i zbatuar nga IADK. Ngjarja u shënuar me certifikimin e afër 60 grave që kanë ndjekur trajnimet për përpunim të ushqimit, pemëve, perimeve dhe të qumështit.

Broshurat dhe pamfletet

Gjatë kohës së zbatimit të projektit janë printuar pamfletet për promovimin e projektit dhe aktivitetëve dhe atë në tri gjuhë: shqipe, serbe dhe angleze. Për më tepër, është dizajnuar dhe printuar broshura në shqip dhe anglisht, e cila është shpërndarë gjatë ngjarjes promovuese të projektit.

Në këtë aktivitet në përgjithësi janë publikuar 1,000 pamflete, 500 broshura dhe 2000 katalogë, të cilat janë shpërndarë tek të gjithë palët e interesit të projektit.

Katalogët e projektit përmbajnë gjitha kontaktet e përfituesve ashtu si janë paraparë në projekt, në mënyrë që të shërbejnë për turistët që vizitojnë zonën e Shalës.



FUQIZIMI I KAPACITETIT TË SHOQËRISË CIVILE PËR POLITIKËBËRJE DHE KONSULTIM ME QEVERINË NË SEKTORIN E BUJQËSISË

Ky projekt ka filluar në dhjetor të vitit 2012 dhe është përfunduar në dhjetor të 2014, që ka përfshirë një periudhë të plotë kohore prej dy viteve me aktivitete të ndryshme në përkrahje të shoqërisë civile në fushën e bujqësisë. Projekti është financuar nga Bashkimi Evropian (BE), ndërsa zbatimin e tij e ka bërë Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë në Kosovë (IADK) në partneritet me Syri i Vizionit (SiV).

Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti ishte mundësimi i dialogut dhe konsultimeve permanente në politikë bërje dhe vendimmarrje, në mes të Qeverisë dhe shoqërisë civile në sektorin e bujqësisë. Tri komponentët kryesore të projektit ishin:

1. Ndërtimin e Kapaciteteve të organizatës së fermerëve në nivel nacional.
2. Promovimin e dialogut dhe bashkëpunimit në mes të institucioneve bujqësore dhe organizatës së fermerëve në nivel nacional.
3. Përfshirja e Organizatës Nacionale të Fermerëve në rrjetet regionale dhe iniciativa për përfshirjen e kësaj organizate në organet e komunitetit Evropian.

Grup i synuar (cak) i këtij projekti ishin anëtarët e Organizatës Nacionale të Fermerëve (101 organizata të fermerëve, kooperativa, shoqata), organizatat rurale të grave dhe organizatat e të rinjve.

Gjatë vitit të kaluar në kuadër të këtij projekti, janë mbajtur trajnime të shumta me fermerë dhe shoqata të fermerëve, dhe përfaqësues të BSHBK, për avokim e lobim dhe trajnime në aftësi komunikuese. E gjitha me qëllim të lehtësimit të punës së fermerëve, në tejkalimin e vështirësive në menaxhimin e biznesit të fermës, komunikim, përgatitje të raporteve, organizimin dhe zhvillimin e strategjive, por edhe në krijimin e kushteve më të mira për të bërë biznes. Përmes projektit janë realizuar edhe vizita studimore jashtë vendit me përfaqësuesit e BASHBK-së, siç është rasti me vizitën në Bullgari në vitin e kaluar, pastaj këtë vit vizita në Gjermani, Maqedoni, Shqipëri, etj.

Vizita studimore në Gjermani

Nga data 7 – 11 Maj 2014 është organizuar një vizitë studimore 5 ditore në landin e Saksonisë së Ulët në Gjermani, ku kanë marrë pjesë tre anëtarë të Bordit të Bashkimit të Shoqatave Bujqësore të Kosovës (BSHBK): z. Agim Sahiti Kryetar, z. Milazim Berisha dhe z. Naser Bajraktari, anëtarë të bordit, z. Mustafë Kastrati organizator/përkthyes, si dhe nga IADK z. Avni Ramadani, Menaxher i Projektit.

Qëllimi i vizitës ishte që përfaqësuesit e BSHBK-së të marrin njohuri nga organizatat e fermerëve në Gjermani, të informohen mbi përvojat e tyre, me formën e organizimit të fermerëve në nivelin lokal, rajonal dhe kombëtar. Pastaj, të marrin përvoja lidhur me çështjet e lobimit dhe avokimit të fermerëve gjerman, mënyrën e konsultimit dhe dialogut me institucionet, qeverisjen lokale dhe qendrore, për të marrë praktikën më të mira nga Gjermania në menaxhimin e bashkimit të fermerëve në nivelin kombëtar.



Gjatë këtyre ditëve janë vizituar: Oda e Bujqve e Saksonisë së Ulët, Qendra për edukimin dhe trajnimin e vazhdueshëm profesional në blegtori, Shoqata e Fermerëve të Saksonisë së Ulët, Qendra kompetente për bujqësi organike dhe Qendra gjermane e trajnimit për Teknologji/Makineri bujqësore.

Vizita studimore në Maqedoni dhe Shqipëri

Një vizitë tjetër studimore është organizuar nga 13-15 Nëntor 2014 në Maqedoni dhe Shqipëri, ku morën pjesë anëtarët e bordit të Bashkimit të Shoqatave Bujqësore të Kosovës - BSHBK. Në këtë vizitë kanë marrë pjesë nëntë (9) anëtarë të bordit të BSHBK-së dhe 2 zyrtarë nga IADK. Në kuadër të kësaj vizite janë vizituar Federata e Fermerëve të Maqedonisë (FFRM), Kompania “Levidia” e cila merret me prodhimin e fidanëve të frutave. Në Shqipëri, përkatësisht në Elbasan është vizituar organizata Agrinet, si dhe një kompani e cila merret me përpunimin e ullinjve dhe prodhon vaj ulliri, e po ashtu edhe organizata “Tjetër Vizion”. Në Durrës është vizituar Instituti i Bujqësisë Biologjike (IBB) dhe është vizituar një fermë me prodhime BIO. Këto vizita kanë qenë mjaft të suksesshme dhe kanë shërbyer si një rast shumë i mirë i komunikimit dhe shkëmbimit të përvojave të fermerëve, organizatave dhe kompanive nga vendet fqinje.



Publikimi i Gazetës Mujore dhe Broshurave

Nga qershori i vitit të kaluar kemi filluar botimin e gazetës mujore, me qëllim të ofrimit të informacioneve të ndryshme për fermerët nga sektori i bujqësisë, pastaj aktiviteteve të BSHBK-së dhe tema të tjera në ngritjen e kapaciteteve. Nga fillimi i botimit të parë e deri në përmbyllje të projektit, janë publikuar 16 numra të gazetës në tri gjuhë (shqipe, serbe dhe angleze). Secili numër është publikuar në 2000 kopje, 1850 në gjuhën shqipe, 100 në gjuhën serbe dhe 50 në gjuhën angleze, ku totali i kopjeve të publikuara është 32000. Në kuadër të këtij aktiviteti janë publikuar po ashtu edhe 5 tituj të ndryshme të broshurave me një numër prej 10000 kopjesh, që do të thotë 2000 kopje për secilën broshurë. Titujt e broshurave janë: Aftësitë e komunikimit, Avokimi dhe Lobimi, Marketingu, Praktikat intensive të kultivimit të mollës dhe Përpunimi shtëpiak i frutave. Njësoj sikur gazeta, edhe broshura është shpërndarë tek të gjitha palët e interesuara në sektorin e bujqësisë, si: fermerët individualë, organizatat dhe shoqatat e fermerëve, MBPZHR, komunat, OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare dhe të institucioneve të ndryshme të sektorit të bujqësisë.



Ueb faqja e BSHBK-së

Është krijuar edhe ueb faqja e BSHBK-së, e cila tashme është online ne internet (www.bshbk.net). Kjo ueb faqe është mirëmbajtur dhe rifreskuar nga IADK, me materiale dhe artikuj të ndryshëm nga sektori i bujqësisë dhe aktivitetet e BSHBK-së. Në total janë publikuar 165 artikuj të ndryshëm. Pas përfundimit të projektit të menaxhuar nga IADK, kredencialet e ueb faqes u janë dorëzuar BSHBK-së dhe tashmë mirëmbajtja e ueb faqes është përgjegjësi e BSHBK-së.

Sigurimi i hapësirës punuese (zyrave) për BSHBK-në

Në kuadër të këtij aktiviteti është bërë e mundur të sigurohet hapësirë pune (zyre) për BSHBK-në dhe anëtarët e saj. Këto zyre janë funksionale dhe të pajisura me të gjitha elementet përcjellëse. Zyrat gjenden në lagjen Arbëria, në këtë adresë: Rr. Ahmet Krasniqi p.n. Objekti “Gratë për Gratë” në Prishtinë. Këto zyre kanë shërbyer për realizimin e disa aktiviteteve të projektit, duke përfshirë trajnimet për BSHBK-në, grupet punuese me MBPZHR-në dhe ngjarje e aktivitete të tjera. Deri në përmbyllje të projektit IADK ka bërë pagesën e qirasë për zyrën e BSHBK-së, dhe mbas projektit edhe financimi dhe mirëmbajtja e zyrës mbetet në përgjegjësinë e BSHBK-së.

Konferencën në nivelin qendror për dialogu me MBPZHR-në

Si vazhdim i pesë punëtorive regjionale, më datën 31 Tetor 2013 në Prishtinë është mbajtur konferenca në nivelin qendror, ku janë paraqitur dhe analizuar të gjeturat nga pesë punëtoritë rajonale me specifikat për secilin region dhe mundësitë për zhvillimin e sektorit të bujqësisë në këtë regjione. Po ashtu janë dhënë rekomandime për MBPZHR-në dhe BSHBK-në, për përmirësimin dhe avancimin e sektorit të bujqësisë. Në këtë konferencë kanë marrë pjesë më shumë se 50 përfaqësues të institucioneve lokale dhe qendrore (komunat, MBPZHR), organizatat e shoqërisë civile (BSHBK, fermer individual, GLV) dhe akter të tjerë nga sektori i bujqësisë në Kosovë.



Konferenca e dytë në nivel qendror

Në vitin 2013 është mbajtur konferenca e parë në nivelin qendror për dialogun me MBPZHR dhe autoriteteve përkatëse për bashkëpunim, ndërsa më 30 prill 2014 në Prishtinë është organizuar konferenca e dytë në nivel qendror, qëllimi i së cilës ka qenë nxitja dhe promovimi i dialogut dhe bashkëpunimit me MBPZHR-në, BSHBK-në dhe akterët tjerë në sektorin e bujqësisë. Tema e konferencës ishte "Politikë bërje për Bujqësi dhe Zhvillim Rural në Kosovë", ku kanë marrë pjesë 62 pjesëmarrës, përfaqësues të institucioneve qendrore dhe lokale (MBPZHR, komunat), organizatave të shoqërisë civile (BSHBK, organizatat e fermerëve), organizatat ndërkombëtare dhe akterë të tjerë nga sektori i bujqësisë në Kosovë. Qëllimi i kësaj konference në nivel kombëtar ishte prezantimi, diskutimi dhe analizimi i Planit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Kosovës (PZHRB) 2014-2020.

Organizimi i seminareve regjionale

Gjatë vitit 2014 IADK ka organizuar edhe 5 seminare regjionale, ku është diskutuar çështja e Aplikimit të Normës së Sheshtë të TVSH-së për prodhuesit bujqësor. Qëllimi i këtyre seminareve ishte informimi dhe vetëdijesimi i shoqërisë civile dhe akterëve tjerë në sektorin e bujqësisë, për çështjen e TVSH-së, gjegjësisht, prezantimi dhe elaborimi i Udhëzimit të ri Administrativ MF - NR. 05/2013 për Aplikimin e Normës së Sheshtë të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), se çka në të vërtetë paraqet ky udhëzim administrativ. Po ashtu është shpjeguar edhe mënyra e kalkulimit dhe implementimit në praktikë, për atë se kush janë përfituesit e normës së sheshtë dhe shumë çështje të tjera në lidhje me TVSH-në, si dhe nxitjen e dialogut mes përfaqësuesve të sektorit të bujqësisë – anëtarëve dhe bordit të BSHBK-së dhe Administratës Tatimore të Kosovës (ATK).

Grupet punuese (Pilot)

Në kuadër të këtij aktiviteti janë mbajtur punëtoritë rreth Subvencioneve dhe Grandeve, që lidhen me nivelin lokal me komunën e Pejës dhe të Mitrovicës. Qëllimi i këtyre punëtorive ka qenë që të përmirësohen praktikat/procedurat e skemës për aplikimin e grandeve dhe subvencioneve në nivelin lokal, të promovohet dialogu dhe bashkëpunimi ndërmjet institucioneve dhe organizatave të fermerëve, të analizohet skema aktuale e subvencioneve dhe grandëve lokale, si dhe të bëhet hartimi i një dokumenti-modeli me praktikat/procedurat dhe skemën për aplikimin e subvencioneve dhe grandëve në nivelin lokal. Gjatë këtyre punëtorive u prezantua gjendja aktuale dhe praktikat e deritanishme, të ndarjes së subvencioneve dhe grandëve nga komuna e Pejës dhe Mitrovicës nga eksperti vendor Nazmi Rapuca, i cili prezantoi në mënyrë kronologjike praktikën e ndarjes së subvencioneve dhe



granateve në sektorin e bujqësisë nga këto dy komuna. Nga këto punëtori kanë dalë këto konkluzione dhe rekomandime:

- Komunitat duhet të rrisin buxhetin për grandeve dhe subvencione në nivel lokal,
- Duhet të hartohen kritere të qarta për mënyrën e shpërndarjes së grandeve dhe subvencioneve,
- Gjatë hartimit të kritereve duhet të konsultohen fermerët, sidomos shoqatat e fermerëve dhe ekspertë të fushave përkatëse,
- Shpërndarja e grandëve dhe subvencioneve duhet të bëhet përmes ftesave publike për aplikim, dhe procedurat të jetë transparente,
- Grandet dhe subvencionet duhet të fokusohen në investime, e të cilat ndikojnë direkt në zhvillimin e bujqësisë,
- Përparësi të ju jepet fermerëve të vegjël dhe të mesëm.

Workshopi për Prodhimtarinë Organike

Një punëtori për prodhimtarinë organike është mbajtur gjatë vitit të dytë të implementimit të projektit, gjegjësisht më 4 Qershor 2014, në të cilën kanë marrë pjesë 13 pjesëmarrës nga institucione të ndryshme, si: përfaqësues të MBPZHR-së, ekspertë të TAIEK-it (nga Ministria e Bujqësisë së Sllovenisë), organizata HINSEE nga Rumania, fermerët dhe IADK-ja. Qëllimi i kësaj punëtorie ishte analizimi i Udhëzimeve Administrative të MBPZHR-së për bujqësinë organike dhe analiza praktike e organizatave joqeveritare në bujqësinë organike. Gjatë seminarit u diskutua për situatën aktuale të bujqësisë, përkatësisht prodhimtarinë organike në vendin tonë, rregulloret e MBPZHR, politikat e udhëzimeve administrative dhe masat lidhur me prodhimtarinë organike dhe prodhimin e ardhshëm organik, si rrugë për zhvillimin e bujqësisë në përgjithësi.

Organizimi i Konferencës së Rrjetit Ballkanik të Shoqatave Bujqësore (BAAN) në Kosovë

IADK dhe BSHBK si anëtarë të Rrjetit Ballkanik të Shoqatave Bujqësore (BAAN), organizuan konferencën e BAAN-it me temën: "Forcimi dhe Bashkëpunimi i Shoqatave Bujqësore në vendet e Ballkanit". Në këtë konferencë u diskutua për bashkëpunimin ndërkufitar, edukimin e fermerëve dhe shërbimet këshillimore rajonale. Qëllimi i konferencës ishte të promovojë organizimin e fermerëve dhe shërbimet këshillimore, por edhe gjetja e mundësive më të mira për bashkëpunim mes vendeve të Ballkanit. Konferenca e BAAN-it u organizua nga 30 Shtatori - 2 tetor 2014 në Prishtinë. Nga të gjithë anëtarët e ftuar të BAAN-it nga vendet e Ballkanit në këtë konferencë kanë marrë pjesë 14 anëtarë, që përfaqëson Shqipërinë, Maqedoninë, Malin e Zi, Serbinë dhe Kosovë, si dhe dy folës të ftuar nga Suedia dhe një folës mysafir nga Hungaria. Për arsye objektive (çështja e vizave) përfaqësuesit nga Bosnja e Hercegovina nuk kanë marrë pjesë në Konferencë. Folës të ftuar në këtë konferencë ishin: Z. Stjepan Taniç, Agro-Ekonomist, Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e Kombeve të Bashkuara (FAO), Zyra Rajonale për Europën dhe Azinë Qendrore, si dhe dy ekspertë suedez, Z. Sten-Rune Lundin dhe Z. Goran Bäckstrand.



Mbështetja e BSHBK-së në bashkëpunim me organizatat nga vendet e BE-së

Që nga themelimi i BSHBK-së në Prill 2013, projekti ka mbështetur procesin e anëtarësimit të BSHBK-së si organizatë partnere me COPA*COGECA, organizatën më të madhe të fermerëve në Bashkimin Evropian, e cila përfaqëson më shumë se 26 milion fermerë dhe rreth 38.000 kooperativa bujqësore. Edhe pse kontaktet e para me COPA*COGECA janë iniciuar përmes z. Wolfgang Jaeger, ekspert gjerman për organizimin e fermerëve, stafi i projektit ka vazhduar komunikimin dhe përpjekjet për t'u regjistruar BSHBK-ne në COPA*COGECA. Pas një pune shumë të vështirë të kryer nga stafi i IADK-së, është bërë i mundur regjistrimi i BSHBK-së në organizatën me prestigjioze të fermerëve në Bashkimin Evropian.

Procesi i anëtarësimit të filluar me aplikimin e UAAK për anëtarësim dhe pastaj në Komitetin Koordinues të COPA*COGECA mbajtur më 12 Qershor, i prezantuar për vendim kryesisë të COGECA më 26 Qershor, dhe kryesisë së COPA-s mbajtur më 27 Qershor, me ç'rast sekretariati mori vendim për të pranuar BSHBK-në si organizatë partnere me COPA*COGECA. Pas lajmit të madh për pranimin e BSHBK-se në COPA*COGECA, projekti ka vazhduar kontaktet me COPA*COGECA dhe ka paguar kuotën vjetore të anëtarësisë së BSHBK-së e cila mbulon 3 vjet, në vlerë prej 6,040.00 Euro.



Gjatë muajit Tetor 2014, COPA*COGECA ka organizuar ngjarjen "Kongresi i Fermerëve Evropiane 2014" në Bruksel. Për këtë arsye, nga data 6-8 Tetor 2014, dy anëtarë të bordit të BSHBK-se (z.Agim Sahiti dhe z.Milazim Berisha) dhe një nga përfaqësuesit i IADK-së (z.Bujar Ahmeti) kanë marrë pjesë në këtë kongres.

Promovimi (eventi) i dytë i projektit EU-CS

Eventi i dytë promovues i projektit është mbajtur me datën 16 Korrik 2014 në Prishtinë. Në këtë aktivitet ishin 67 pjesëmarrës, përfaqësues nga MBPZHR, IADK, BSHBK, fermerë, prodhues, Fakulteti i Bujqësisë, Banka Botërore, UNDP, NOA/USAID, GIZ-i, si dhe organizata të tjera qeveritare dhe jo-qeveritare, pjesëmarrësit tjerë nga shoqëria civile nga fusha e bujqësisë.

Pjesëmarrësit kanë diskutuar lidhur me rolin e shoqërisë civile dhe konsultimit të organizatave të fermerëve gjatë hartimit të politikave nga ana e Qeverisë në sektorin e bujqësisë. Në këtë takim u kërkuar që përveç konsultimit të organizatave të fermerëve gjatë hartimit të politikave, sfidat që po ngritën nga shoqëria civile dhe nga fermerët e prodhuesit bujqësor të bëhen prioritet të punës së MBPZHR-së.

Promovimi (eventi) i tretë i projektit EU-CS

Eventi i tretë, që njëherësh ishte edhe përmbyllës i këtij projekti, është mbajtur me datën 24 Nëntor 2014 në Hotel Emerald në Prishtinë. Në këtë aktivitet ishin 130 pjesëmarrës, përfaqësues nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, MBPZHR, IADK, BSHBK, fermerë të shumtë, prodhues, përpunues, Banka Botërore, UNDP, NOA/USAID, GIZ-i, si dhe organizata të tjera qeveritare dhe jo-qeveritare, pjesëmarrësit tjerë nga shoqëria civile dhe mediat. Ky event promovues u moderua nga Drejtori Ekzekutiv i IADK-së, z. Zenel Bunjaku, ndërsa në panel ishin edhe z. Christof Stock, Shef i Bashkëpunimit në Zyrën e BE-së në Kosovë, znj. Shqipe Dema, Drejtoreshë e Departamentit të Politikave të Zhvillimit dhe Kryetare e Autoritetit Menaxhues në MBPZHR, z. Safet Kamberi, Nënkyetar i Komunës së Mitrovicës, znj. Arta Haxhaj, Drejtoreshë e Drejtorisë komunale për ekonomi e bujqësi në Vushtri, z. Agim Sahiti, Kryetar i BSHBK-së.

Në këtë event përmbyllës janë prezantuar të gjitha të arriturat dhe aktivitetet e projektit EU-CS, por edhe të EU-RT. Të arriturat kryesore të projektit (eventi promovues, konferenca e BON-it, ceremonia e certifikimit e shume aktivitetet) janë ndjekur dhe prezantuar nga stacionet kombëtare televizive si (RTK, KTV, RTV21 dhe Klan Kosova), mediat e shkruara dhe elektronike.

SHËRBIME TJERA NGA IADK

Ofrimi i shërbimeve këshillimore për fermerë të përkrahur nga Komuna e Vushtrrisë

Në kuadër të Marrëveshjes për Bashkëpunim (MpB) mes IADK-së dhe Komunës së Vushtrrisë, këtë vit Komuna e Vushtrrisë ka bashkëfinancuar edhe disa projekte të cilat IADK ka zbatuar te fermerët e Vushtrrisë nga donatorët e vet. Në këtë mënyrë, nga ky bashkëfinancim i Komunës së Vushtrrisë është rritë numri i përfituesve në këtë komunë. Po ashtu me një aneks të veçantë, IADK dhe Komuna e Vushtrrisë kanë bërë një financim të përbashkët për ofrimin e këshillave profesionale për fermerët përfitues të serrave, bletëve dhe makinave mjelëse, të cilat i ka shpërndarë komuna nga buxheti i saj. Në këtë mënyrë stafi profesional i IADK-së ka ofruar trajnime dhe këshilla praktike për teknikat e kultivimit të perimeve në serra, përkujdesën ndaj bletëve, përdorimin e makinave mjelëse dhe përmirësimin e higjienës së qumështit, si dhe trajnime ekonomike për menaxhimin e biznesit të fermës.



Shërbime profesionale për Laboratorin e Aktiviteteve të Biznesit (LAB) në Han të Elezit

Gjatë vitit 2014 IADK ka ofruar shërbime profesionale në fushën e hortikulturës dhe shërbime administrative, financiare dhe menaxheriale për LAB në Han të Elezit, ku është duke u zbatuar një projekt i përkrahjes së fermerëve në këtë komunë. Pasi që LAB ishte me një staf të vogël në fazat e para të zbatimit të projektit, të cilët nuk kanë përvojë të mjaftueshme për implementimin e projektit, ka zgjedhur IADK-në që të ofrojë trajnime profesionale si për stafin e vet menaxherial, ashtu edhe trajnime dhe këshilla praktike në teren për fermerët përfitues. Ky aktivitet do të vazhdoj edhe gjatë vitit 2015, ku fermerët përfitues të mjedrave, dredhëzave dhe serrave do të monitorohen dhe do të këshillohen për teknikat e kultivimit të kulturave të lartcekura.



Trajnimet promovuese

Nga një buxhet simbolik të përkrahur nga MBPZHR në këtë vit, IADK ka realizuar projektin “Promovimi i kultivimit të bimëve mjekësore, energjisë diellore dhe silazhimit në bujqësi”. Aktivitetet e projektit janë shtrirë në komunat e rajonit të Mitrovicës (Mitrovicë, Vushtrri, Skenderaj), dhe rajonit të Prishtinës (Prishtinë, Podujevë, Drenas, Lipjan, Shtime, Obiliq dhe Novo Bërd). Në secilën komunë është mbajtur nga një trajnim për kultivimin e bimëve aromatike mjekësore, të cilat i kanë përcjellë 158 fermerë. Ata janë trajnuar për mënyrën e përgatitjes së silazhit të barit dhe misrit ku kanë marrë pjesë 109 fermerë, pastaj në pesë komuna janë mbajtur trajnime për shfrytëzim të energjisë diellore në bujqësi ku kanë marrë pjesë 71 fermerë, si dhe janë organizuar tri udhëtime studimore brenda vendit për kultivim të bimëve mjekësor, shfrytëzim të energjisë diellore dhe një fermë më e avancuar e lopëve qumështor, në të cilat kanë marrë pjesë gjithsejtë 43 fermerë. Në kuadër të projektit janë përgatitur dy fletëpalosje me nga 500 kopje, të cilat u janë shpërndarë fermerëve dhe komunave përkatëse ku është implementuar projekti. Njëra fletëpalosje ka pasur përmbajtje të shkurtër për kultivimin e bimëve aromatike mjekësore, ndërsa tjetra për teknikën e përgatitjes së silazhit të barit dhe misrit.



Trajnim për bimët mjekësore

Udhëtim studimorë në Istog

Rrjeti i të Dhënave për Kontabilitet të Fermave –RrDhKF (FADN)

Edhe gjatë vitit 2014 IADK ka vazhduar aktivitetet për grumbullimin e të dhënave nga 400 ferma të Kosovës, në bazë të projektit dy vjeçar 2013/2014 të kontraktuar nga MBPZHR. Stafi përgjegjës për këtë projekt ka grumbulluar të dhënat nga fermat përmes plotësimit të Librit të Fermës dhe këto të dhëna janë vendosur në formën elektronike, në softuerin përkatës, ku janë përpunuar të dhënat e kontabilitetit të fermave dhe janë dorëzuar në departamentin përkatës të Ministrisë së Bujqësisë.

Ngritja e kapaciteteve lokale në gjenerimin e punësimit

Në kuadër të këtij projekti të përkrahur nga UNDP, si përfutjes kyç kanë qenë Komuna e Dragashit dhe Shtërpçës. Qëllimi i projektit ka qenë krijimi i kapaciteteve institucionale dhe lokale, të cilat do të lehtësojnë kalimin nga aktivitetet ekonomike të mbijetesës në biznes në aktivitetet ekonomike të orientuara nga tregu.

Grupet e targetura në këtë projekt kanë qenë të ndara në dy grupe: zyrtarët e komunave e bizneset lokale dhe shoqatat lokale e fermerët nga të gjithë sektorët.

Për të arritur rezultatet e pritura nga projekti, IADK ka trajnuar stafin komunal në dy komunat përkatëse të cilët janë të përfshirë në ofrimin e shërbimeve për zhvillim ekonomik dhe zhvillimit të integruar rural. Në këtë aspekt pjesëmarrësit janë trajnuar në pesë (5) sesione të trajnimit, si: Përgatitja e projekt-propozimeve për fonde të ndryshme, trajnimin në zinxhirin e vlerës në sektorin e bujqësisë, zhvillimin e turizmit me fokus turizmin rural dhe rregullat dhe rregulloret për përdorimin e resurseve në kuadër të parkut kombëtar, në kontekstin e zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK).

Grupi i dytë i targetuar është trajnuar në shtatë (7) sesione të trajnimit në temat: përgatitja e biznes planeve për ndërmarrjet e vogla, përgatitja e projekt-propozimeve për MBPZHR dhe donatorëve tjerë, identifikimin e kulturave më profitabile në Kosovë, menaxhimin e shoqatave, analizimi dhe identifikimi i tregut, zinxhiri i vlerës në sektorin e qumështit dhe mjaltit dhe zinxhiri i vlerës në sektorin e hortikulturës. Gjatë projektit janë trajnuar 215 pjesëmarrës nga komunat përkatëse.

Bashkëpunimi mes IADK-së dhe projektit PPSE “Promovimi i punësimit në sektorin privat“

Gjatë vitit 2014 në kuadër të projektit PPSE i cili zbatohet nga Swiss kontakti, IADK është kontraktuar për kryerjen e shërbimit në ngritjen e kapaciteteve në çështjen e ndjeshme gjinore në zinxhirin e vlerës në Kosovë.

Gjatë kësaj periudhe IADK së bashku me ekspertin nga GIZ, por edhe me ekspertet nga organizata Agri-Pro-Focus e Holandës, kanë organizuar punëtorinë fillestare në ngritjen e kapaciteteve në çështjen e ndjeshme gjinore në zinxhirin e vlerës për stafin e projektit dhe aktorëve lokalë që punojnë në zhvillimin e zinxhirit të vlerës në Kosovë. E gjitha kjo për të bërë punën e tyre më shumë sensitive gjinore dhe për të promovuar fuqizimin ekonomik të grave në punën e përditshme të bujqësisë.



Më pas ekspertët e IADK-së dhe GIZ-it kanë vizituar organizatat, të cilat janë të motivuara për të punuar në çështjen gjinore dhe zinxhirin e vlerës, ku këto organizata kanë qenë pjesë e punëtorisë, siç janë: MBPZHR, Institucione tjera, OJQ të ndryshme etj, ku gjatë kësaj kohe së bashku me përfaqësuesit e këtyre organizatave dhe institucioneve kanë krijuar planin e veprimit për çështjen gjinore për aktivitetet e tyre.

Përgatitja e projekt-propozimeve dhe biznes-planeve

Gjatë gjithë vitit stafi i IADK-së nga të gjithë sektorët kanë pritë vazhdimisht fermerët në zyre për ofrimin e këshillave të ndryshme profesionale si dhe këshilla sa i përket thirrjeve për aplikim në grande të ndryshme, si dhe ka ndihmuar fermerët dhe kompanitë në përgatitjen e projekt-propozimeve dhe plan-bizneseve të ndryshme. Gjithsejtë janë përgatitur 8 aplikacione për grande të ndryshme ku gjysma e tyre janë aprovuar.

PUBLIKIMET

Gjatë vitit 2014 IADK ka përgatitur dhe publikuar 9 broshura dhe 11 fletëpalosje, për të gjithë sektorët e bujqësisë. Broshurat dhe fletëpalosjet janë përgatitur në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht.

Broshura:

1. Prodhimtaria organike e bimëve mjekësore.
2. Praktikat mbi prodhimin intensiv të mollës.
3. Përpunimi shtëpiak i pemëve dhe perimeve.
4. Përpunimi shtëpiak i pemëve, perimeve dhe brumit.
5. Përpunimi shtëpiak i pemëve
6. Avokim dhe Lobim
7. Aftësi Komunikuese
8. Marketing
9. Raporti vjetor IADK 2013

Fletëpalosjet:

1. Qendra e Edukimit të Fermerëve“
2. 10 Vjetori i IADK-së
3. Plehërimi dhe pasurimi i tokës
4. Bletët polenizuese
5. Inspektimi, certifikimi dhe akreditimi
6. Bimët aromatike dhe mjekësore
7. Përgatitja e silazhit të barit
8. ODA-Jakup Xhafa-Bare
9. ODA-Miftar Istrefi-Bajgorë
10. ODA-Selim Beqiri-Sllakov
11. Bashkimi i Shoqatave Bujqësore të Kosovës

Të tjera:

Katalogu; Turizmi në zonën e Shalës
 Manuali Turistik
 Publikimi i 10 nr. të Gazetës mujore
 Përmbledhje e 16 nr. të Gazetës mujore



AKTIVITETE ME PARTNERË PROFESIONAL INTERNACIONAL

Ekspertët Seniorë të PUM nga Holanda – gjatë vitit 2014 kanë realizuar 6 misione

Në sektorin e blegtorisë gjatë vitit 2014 është realizuar një mision nga një ekspert i organizatës PUM. Gjatë këtij misioni fermerët janë trajnuar për tema të ndryshme në lëmin e bletarisë, përfshirë mënyrat e kultivimit, shumimin e bletëve, mbrojtjen nga sëmundjet dhe dëmtuesit, përgatitjen për dimërim, etj.

Në sektorin hortikulturës është realizuar një mision me ekspertin e organizatës PUM, për mënyrën e menaxhimit të ujërave. Gjatë këtij misioni janë vizituar kompani të ujitjes, fermerë të ndryshëm dhe kanalet e ujitjes, si dhe janë dhënë këshilla e përvoja për sistemet e menaxhimit të ujërave në Holandë.

Në sektorin e përpunimit është realizuar një mision me ekspertin nga organizata PUM. Gjatë këtij misioni janë trajnuar gratë e punësuar në kuzhinat e shkollave, gratë të cilat përgatisin ushqim me porosi, punëtorë të fabrikave të miellit, të punësuarit e restoranteve të cilët janë direkt të inkuadruar në përgatitjen e ushqimit. Gjithashtu janë vizituar pikat përpunuese me qëllim të vlerësimit e përmirësimit të mënyrës së promovimit dhe përmbajtjes së etiketave në produkte.

Tri misione tjera të ekspertëve të PUM-it, janë realizuar në kuadër të gjithë sektorëve të IADK-së, me qëllim të ofrimit të përvojave të tyre në fushat përkatëse, si: turizëm **rural**, **marketing** dhe **menaxhim të shoqatave**.

Shkëmbimi i përvojave me organizatën AFDI nga Franca

Me organizatën AFDI ka vazhduar bashkëpunimi, me qëllim të bartjes së përvojave në sektorin e blegtorisë. Gjatë vitit 2014 përfaqësuesit e AFDI-së kanë realizuar një vizitë në Kosovë, me qëllim që t'i ndihmojnë fermerët në menaxhimin sa më të mirë të fermave në rritjen e produktivitetit të fermës.

Po ashtu gjatë këtij vitit IADK ka organizuar një vizitë studimore në Francë, ku kanë marrë pjesë dy (2) përfaqësues nga stafi i vet, një përfaqësues nga MBPZHR dhe një fermerë. Vizita ka zgjatur dhjetë (10) ditë, ndërsa qëllimi kryesor i vizitës ka qenë që pjesëmarrësit të njoftohen me praktikatat e reja në menaxhimin e fermave, organizimin e fermerëve dhe funksionimin e shoqatave të fermerëve.

TREGIM SUKSESI - KUZHINIERET QË SFIDOJNË PARAGJYKIMET

Kuzhina e Shkollës Fillore “Anton Zako Çajupi” në fshatin Begaj të Vushtrrisë, u ngjason kuzhinave në shtëpi. Për dallim nga kuzhinat shtëpiake, kjo kuzhinë ka katër kuzhinierë. Por ato nuk kanë kohë për fjalë.

Rreth 600 nxënës të kësaj shkolle çdo ditë hanë mëngjesin në këtë kuzhinë, ku i presin picat, hamburgerët, kiflet, biskotat, tostat, byrekët e llokumet e nxehta të përgatitura nga Vildane Mulaku, Fatmire Aliu, Rifadije Pupova dhe Minire Beka.

Këto gra punojnë nga e hëna deri të premten për dy ndërrimet e nxënësve. Një projekt i nisur në shkurt 2013, Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës (IADK), u ka ndihmuar atyre të dalin nga rrethi i paragjytimeve. Me punën në këtë kuzhinë katër gratë, të cilave bashkëshortët u janë vrarë në luftën e fundit, tani janë të pavarura dhe gjenerojnë të ardhurat e familjes.

Sfida e paragjytimeve

Vildanja është 40-vjeçare. Pa i mbushur të 25-tat, kishte mbetur e ve. Ushtria serbe ia kishte pushkatuar burrin, duke e lënë me djalin 2 vjeç e gjysmë, ndërsa 6 javë pas vrasjes asaj do t'i lindte një vajzë.

Histori të ngjashme me të kanë edhe tri kuzhinieret e tjera. Njëra ka gjashtë fëmijë, kurse dy të tjerat nga dy. Ato i bashkon aty dhembja e njëjtë dhe barra e rëndë e përgjegjësisë për mbajtjen e familjes.

“Qeshim bashkë, flasim bashkë, qajmë bashkë”, thotë Vildanja. Kishte qenë e vështirë të bindeshin këto gra që të fillonin punën në këtë kuzhinë.

“Paj mentaliteti këtu është pak më ndryshe. Por fatmirësisht unë kam familjen e burrit shumë të mirë, edhe më kanë përkrahur “Plot gra na thonë me ua gjet një punë kështu si na”, tregojnë ato. Gratë kryefamiljare i falënderohen organizatës IADK-së që sipas tyre, përveçse në aspektin financiar u ka ndihmuar edhe në aspektin moral. Ato thonë se jeta e tyre ka qenë e vështirë pas humbjes së kryefamiljarëve. Vildanja tregon se për vite të tëra nuk kishte dalë askund. “Kemi ndejt veç brenda. Tash po punojmë, jemi aktivizuar. Në shtëpi veç na shtoej mërzia”, thotë ajo.

Ushqime të freskëta

Mishi, kaçkavalli, djathi, sallamet e gjërat e tjera nuk ruhen kurrë as për 24 orë në kuzhinën e katër grave kryefamiljare, sepse të gjitha shpenzohen brenda ditës.

Në fund të muajit këto katër gra arrijnë të nxjerrin nga një rrogë mbi 200 euro për veten. “Krejt me shpenzimet tona e blejmë edhe harçin, edhe rrogat”, tregon ajo.

Mësimdhënësit lavdërojnë ato për shijen edhe nivelin e pastërtisë së kësaj kuzhine. “Unë u kam thënë edhe në mbledhje të arsimtarëve, se unë ulem me hangër me secilin nxënës bukë. Përveç ushqimit të mirë, e mbajnë edhe shumë pastër”, thotë mësuesja Igballe Gërzhaliu.

Porsa zilja e shkollës tregon përfundimin e pushimit, katër gratë fillojnë përgatitjen e ushqimit, për ndërrimin tjetër.




Vizitat e stafit dhe vizitat me fermer gjatë vitit 2014					
Nr.	Vendi	Datat	Nr. i ditëve	Nr.i pjesm.	Spektori
1	Kosovë	29.04.2014	1	17	Menaxhim Biznesi
2	Kosovë	17.09.2014	1	31	Hortikulturë
3	Kosovë	19.09.2014	1	15	Hortikulturë
4	Kosovë	27.09.2014	1	14	Hortikulturë
5	Kosovë	30.09.2014	1	80	Perpunim Ushqimi
6	Kosovë	20.11.2014	1	31	Blegtari
7	Kosovë	20.11.2014	1	17	Blegtari
8	Kosovë	04.12.2014	1	29	Përpunim Ushqimi
9	Shqipëri	21.03.2014	1	2	Hortikulturë
10	Shqipëri	06.05.2014	1	10	Blegtari
11	Shqipëri	23-24.09.2014	2	15	Menaxhim Biznesi
12	Shqipëri	14-15.11.2014	2	12	Organizim i fermerve
13	Maqedoni	31.05-01.06.2014	2	17	Stafi
14	Maqedoni	19.06.2014	1	2	Organizim i fermerve
15	Maqedoni	19-20.06.2014	2	13	Hortikulturë
16	Maqedoni	23-24.06.2014	1	11	Hortikulturë
17	Maqedoni	13-14.11.2014	2	12	Organizim i fermerve
18	Maqedoni	20.11.2014	1	13	Perpunim Ushqimi
19	Serbi	22-23.05.2014	1	3	Menaxhim Biznesi
20	Serbi	22-23.05.2014	1	16	Hortikulturë
21	Serbi	26-27.05.2014	1	16	Hortikulturë
22	Mal I zi	30.03-03.04.2014	5	1	Menaxhment
23	Kroaci	17-20.06.2014	4	1	Menaxhment
24	Holand/Francë	19-28.01.2014	9	1	Menaxhment
25	Gjermani	11-13.02.2014	3	1	Menaxhment
26	Gjermani	07-11.05.2014	4	5	Organizim i fermerve
27	Gjermani	06-08.10.2014	3	3	Organizim i fermerve
28	Finland	04-10.09.2014	6	1	Menaxhment
29	Turqi	12-15.10.2014	3	1	Menaxhment
30	Danimark/Suedi	06-16.11.2014	10	1	Menaxhment
31	Francë	07-14.12.2014	7	2	Blegtari
			80	393	

Të hyrat e IADK-së nga Partnerët dhe Donatorët për vitin 2014


Nr.	Emri i Donatorit/Partnerit	Emri dhe Kohëzgjatja e Projektit	Shuma € për 2014	Përqindja %
1	Zyra e Komisionit European në Kosovë	Fuqizimi i kapaciteteve të shoqërisë civile në bërjen e politikave dhe dialogut me Qeverinë në sektorin e Bujqësisë (2012-2014)	118,432	14.1%
2	Zyra e Komisionit European në Kosovë	Promovimi i turizmit rural dhe infrastrukturës në regjionin e Shalës	241,866	28.7%
	Komunat		17,750	2.1%
3	Zyra e Komisionit European në Kosovë	Fuqizimi Ekonomik dhe ndërtimi i kapaciteteve të grave të veja në regjionin e Mitrovicës/Mitrovica dhe Prishtinës/Priština	357	0.0%
4	Bread for the World	Edukimi dhe Konsolidimi i Fermerëve në Kosovë (2012-2014)	167,103	19.9%
	Church of Sweden		103,122	12.3%
5	MBPZHR	FADN - Mbledhje e të dhenave për fermerë	16,954	2.0%
6	MBPZHR	Promovimi dhe kultivimi i bimeve mjekësore, energjisë alternative në bujqësi dhe sillazhimi	3,879	0.5%
7	Ambasada Kanadeze	Fuqizimi i grave në sektorin e bujqësisë dhe krijimi i lidhjeve të tregut	798	0.1%
8	Ambasada e Holandës	Fuqizimi i Zhvillimit Ekonomik dhe rekonsilimi në mes serbeve, shqipëtarëve dhe fermerëve tjerë të minoriteteve në Kosovën veriore	12,466	1.5%
9	Komuna e Vushtrise	Pemishte të Mjedes	24,500	2.9%
10	UNDP	Prodhimi i perimeve në serra në Jug të Mitrovicës	9,480	1.1%
11	UNDP	Rritja e kapaciteteve të fermereve në Hortikulturë në regjionet Veri dhe Jug të Kosovës	46,642	5.5%
12	UNDP	Trajnime për fermerë, ndërmarrje të vogla dhe zyrtarë të komunave në komunat e targetuara	11,000	1.3%
13	SWISS	Trajnime lidhur me barazi gjinore	2,758	0.3%
14	Të hyrat tjera	Të hyrat e ndryshme për shërbime të fermerëve, kompanive, Kontributi lokal për projektin nr. 4	64,429	7.7%
	Gjithsej		841,535	100%

Koment: Të gjitha të hyrat e paraqitura janë të hyra që janë njohur gjatë vitit 2014, përfshirë edhe të hyrat e shtyra nga viti 2013.



Invesimet e IADK-së në sektorët e bujqësisë për vitin 2014

	Emri i Sektorit	Shuma € për 2014	Përqindja %
1	SEKTORI I HORTIKULTURËS	169,065	21%
2	SEKTORI I BLEGTORISË	71,098	9%
3	SEKTORI I PËRPUNIMIT	74,440	9%
4	ORGANIZIMI I FERMERËVE	156,059	19%
5	TURIZMI RURAL	238,967	30%
6	SHPENZIMET ADMINISTRATIVE	95,759	12%
	Total	805,387	100%



Stafi i IADK-së për vitin 2014

Emri dhe Miemri	Departamenti	Pozita
Zenel Bunjaku	Menaxhment	Drejtor Ekzekutiv
Gursel Arifi	Blegtori	Zv.Drejtor dhe Udhëheq.i Dep.Blegtorisë
Khavit Shala	Blegtori	Inxhinier i Blegtorisë
Esma Azemi Këpuzi	Financa, Logjistikë, Administratë&Prokurim	Menaxhere për Financa, Logjistikë & Administratë
Ariana Selmani Peci	Financa, Logjistikë, Administratë&Prokurim	Zyrtare për Prokuim, Logjistikë & Administratë
Elheme Shala	Financa, Logjistikë, Administratë&Prokurim	Asistente e zyres
Petrit Koci	IT / Administratë	Mirëmbajtës i rrjetit/sistemit
Edlira Pllana	Administratë	Zyrtare e Marketingut
Basri Hyseni	Hortikulturë	Udhëheqës i Dep. të Hortikulturës
Sylejman Bunjaku	Hortikulturë	Inxhinier i Bujqësisë - Perimtari
Skender Fejzullahu	Hortikulturë	Inxhinier i Bujqësisë – Pemëatri
Edita Mahmuti	Hortikulturë	Asistente e Bujqësisë
Novica Markovic	Hortikulturë	Inxhinier i Hortikulturës
Mimoza Istrefi	Hortikulturë	Asistente në Hortikulturë
Magbule Hyseni	Përpunim	Udhëheqëse departamentit të organizimit të fermerëve dhe përkrahjes së grave
Hanumshahe Zeneli	Përpunim	Asistente e Projektit
Hafize Veseli Sylejmani	Përpunim	Zyrtare e Projektit/Përpunim shtëpiak
Kreshnik Sadiku	Turizmi Rural	Projekt Menaxher
Veton Maloku	Turizëm Rural	Inxhinier i Ndërtimtarisë
Nexhmedin Melenica	Turizëm Rural	Inxhinier i Ndërtimtarisë
Avni Ramadani	Proj.i shoqërisë civile	Projekt Menaxher
Bujar Ahmeti	Proj. i shoqërisë civile	Zyrtar i Projektit
Fehmi Basholli		Kujdestar i objektit

Praktikantët gjatë vitit 2014

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Departamenti
1	Gentianë Ibra	Financa
2	Adhurim Maloku	Financa
3	Valbonë Hyseni	Financa
4	Blerta Paci	Financa
5	Mimoza Istrefi	Hortikulturë
6	Edlira Pllana	Hortikulturë
7	Valdete Berisha	Përpunim i ushqimit
8	Nazlije Berisha Klinaku	Përpunim i ushqimit & Administratë
9	Gonxhe Dobroshi	Përpunim i ushqimit
10	Arife Gashi	Përpunim i ushqimit

Raporti vjetor 2014

Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës

Adresa: Fshati Sfaraqaku i Ulët n/n 42000

Vushtrri, Republika e Kosovës

Tel: +381 (0) 28 536 726

E-mail: info@iadc.org

Web. www.iadc.org

